



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 37 regjistër (JR)
Datë 16.09.2020

Nr. 25 i vendimit
Datë 06.07.2022

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 06.07.2022, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Spartak Çoçoli, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 274, datë 16.07.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Spartak Çoçoli.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; neni F i Aneksit të Kushtetutës; neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 1, 2, 63 dhe 66, pika 1, shkronja “b”; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, neni 46; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 274, datë 16.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Spartak Çoçoli (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.
2. Në funksion dhe në zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional. Në vijim të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe c) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), prej të cilave rezultoi:
3. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportet¹ për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.
4. KLP-ja ka hartuar raportin me nr. {***} prot., datë 26.12.2019, për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Ky raport është bazuar në formularin e vetëdeklarimit; në 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit; në të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i

¹ Raportet e DSIK-së, datë 02.11.2017 dhe raporti, datë 09.03.2020.

rivlerësimit; në 5 dosjet hetimore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; në të dhënat nga burimet arkivore të prokurorisë. KLP-ja shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe analizoi të dhënat në 8 dosjet, referuar neneve 71 – 76 për kriteret e vlerësimit sipas ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”).

5. Në përputhje me nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe me nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit, zhvilloi procesin e rivlerësimit kalimtar bazuar në dy kriteret e vlerësimit, atë të kontrollit të kriterit të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale dhe mori vendimin objekt shqyrtimi nr. {***}, datë 16.07.2020.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

6. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, bazuar në nenin 179/b, në nenin E, pikat 4 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 61, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Spartak Çoçoli, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.*
7. Ky vendim është marrë në vijim të konkluzioneve të mëposhtme për secilin prej kriterëve të vlerësuar.

7.1 Për kriterin e kontrollit të figurës: [...] *Rëndësia e integritetit të figurës së gjyqtarit apo prokurorit, duhet të qëndrojë në themel të procesit të rivlerësimit. Në këto kushte, konkluzionet e arritura gjatë hetimit të pastërtisë së figurës për z. Spartak Çoçoli, të ndërthurura me hetimin dhe vlerësimin e rasteve gjatë hetimit dhe vlerësimit profesional, vlerësohen se subjekti i rivlerësimit gjendet në situata të përsëritura në shkelje të ligjit, të cilat rëndojnë pozitën e tij si prokuror dhe kanë për qëllim anësi në vendimmarrjet e tij lidhur me pushim të hetimeve si të pabazuar në ligj dhe në prova. Këto veprime, të vlerësuara në tërësinë e tyre, cenojnë rëndë besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, në kuptim të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

7.2 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: *Trupi gjykues vlerëson se në rastet kur gabimet e subjekteve të rivlerësimit evidentohen që përsëriten në mënyrë të vazhdueshme dhe në praktika të ndryshme, përbëjnë përjashtim nga rastet e konfirmimit në detyrë dhe ato duhet të vlerësohen negativisht. Në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, si dhe nuk ka respektuar të drejtat e palëve, ndaj ai konsiderohet “i papërshtatshëm”, pasi mangësitë vlerësohen të tilla që nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, pasi rezultoi i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale. Nga vlerësimi tërësor dhe, kryesisht për sa i takon aspektin etiko-profesional, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka cenuar*

besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe, për rrjedhojë, duhet aplikuar edhe pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

III. Mbi ankimin dhe shkaqet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit

8. Më datë 18.08.2020, me nr. {***} prot., subjekti i rivlerësimit ka depozituar pranë Komisionit ankimin kundër vendimit nr. 274, datë 16.07.2020, me të cilin është njoftuar më datë 06.08.2020. Ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor, sipas nenit 63², pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nënshkruar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në konkluzion të ankimit të tij, si edhe në parashtrime, subjekti i rivlerësimit kërkoi që shkaqet e ankimit t'i marrë në shqyrtim Kolegji dhe, në përfundim, kërkoi:

8.1 Gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.

8.2 Ndryshimin e vendimit nr. 274, datë 16.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

8.3 Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Spartak Çoçoli, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

8.4 Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

Lidhur me shkaqet e ankimit me natyrë procedurale

8.4.1 Subjekti i rivlerësimit pretendon se në Komision i është nënshtruar procesit të rivlerësimit bazuar vetëm në dy kriteret e vlerësimit, atë të figurës dhe të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, si dhe në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, duke mos u vlerësuar për kriterin e vlerësimit të pasurisë.

8.4.2 Subjekti i rivlerësimit pretendoi se i është drejtuar Komisionit me kërkesë për shtyrje të seancës dëgjimore për shkaqe shëndetësore. Subjekti argumenton se ka qenë në pamundësi kohore për shkak të periudhës së pandemisë dhe, duke mos ia pranuar shtyrjen e zhvillimit të gjyqimit, nuk i është dhënë mundësia të shprehet, të japë shpjegimet e tij, duke qenë i pranishëm gjatë gjyqimit.

Shkaqet e ankimit lidhur me kontrollin e figurës.

8.4.3 Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se në procesin e tij të rivlerësimit në Komision, nuk është sqaruar se si në dy raportet e DSIK-së të datave 02.11.2017 dhe 28.03.2018, subjekti rezulton i përshtatshëm për të vazhduar detyrën, ndërsa në raportin e datës 10.03.2020, subjekti i rivlerësimit Spartak Çoçoli rezulton i papërshtatshëm për të vazhduar detyrën. Për të gjitha konstatimet e Komisionit, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk është informuar se në çfarë kushtesh janë kryer veprimet që i atribuohen subjektit sipas raportit të DSIK-së.

² "Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apelimeve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit".

Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

8.4.4 Subjekti i rivlerësimit pretendon se gjetjet e Komisionit për analizimin e aftësive profesionale janë ta pabazuara dhe subjektive. Në këtë vendim, rezulton se nuk është analizuar thelbi i një akti procedural, që është vendimmarrja. Në asnjë prej akteve procedurale të vëzhguara nga ana e Komisionit nuk evidentohet nëse vendimet e marra kanë qenë të drejta apo jo. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se, nëpërmjet provave të administruara, si dhe shpjegimeve të tij, arrin nivel besueshmërie në vlerësimin e pasurisë dhe në kontrollin e figurës, ndërsa sa u përket aftësive profesionale, i kërkon trupit gjykues të Kolegjit aplikimin për subjektin të “Pezullimit nga detyra dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit”, sipas nenit 60 të ligjit nr. 84/2016, dhe jo aplikimin e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që parashikon “Shkarkimin nga detyra” për subjektin e rivlerësimit.

8.4.5 Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankimin e paraqitur prej tij, se nuk ka marrë pjesë në aktivitetet trajnuese në kuadër të Programit të Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, gjatë periudhës 3-vjeçare të rivlerësimit, si dhe jashtë kësaj periudhe, duke shpjeguar se mungesa nga ana e tij, ka ardhur për shkak të ngarkesës së madhe në punë.

8.4.6 Subjekti i rivlerësimit pretendoi se me urdhrin nr. {***}, datë 16.02.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm, është dhënë ndaj tij masa disiplinore “vërejtje” në lidhje me një akt procedural “zgjatje e afatit të hetimit”, që i përket një procedimi penal, por një urdhër i tillë mund të ndodhë t’i jepet çdo prokurori për shkak të ngarkesës në punë.

8.4.7 Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet ankimit, pretendoi se për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2016, në lidhje me njohuritë ligjore, arsyetimet ligjore, aftësitë organizative, aftësisë për të përballuar ngarkesën në punë, për të cilat është vlerësuar “mjaftueshëm” në disa raste dhe “mirë” në disa raste të tjera, nuk është ushtruar asnjëherë kontroll nga Prokuroria e Përgjithshme, duke mos ditur se si kjo prokurori ka arritur në këto konkluzione.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

i. Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka në objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka kryer rivlerësimin e subjektit Spartak Çoçoli, duke vendosur shkarkimin e tij nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. *Legjitimimi i ankuesit*

10. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

11. Në përputhje me nenin 65³, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 274, datë 16.07.2020, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Spartak Çoçoli, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi.

11.1 Kolegji shqyrtoi fillimisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit të paraqitur në ankim për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.

11.2 Në këndvështrim të të gjitha konkluzioneve të paraqitura në vendimin e Komisionit dhe të gjitha pretendimeve të parashtruara në ankimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues nuk evidentoi ndonjë shkelje procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor në Kolegji për korrigjimin e tyre, siç pretendon subjekti i rivlerësimit. Në këto kushte, pretendimi i tij që Kolegji të shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore publike, gjendet i pabazuar, pasi rezulton se kjo e drejtë i është respektuar nga Komisioni në seancën dëgjimore dhe subjekti ka ushtruar të drejtën e paraqitjes së provave dhe shpjegimeve gjatë zhvillimit të procesit në Komision.

11.3 Në përputhje me nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, gjykimi në Kolegji, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh, në dhomë këshillimi. Trupit gjykues të Kolegjit nuk i rezultoi i nevojshëm shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore publike për t'i dhënë mundësi subjektit të rivlerësimit për t'u dëgjuar edhe në Kolegji. Kjo edhe për faktin se kërkitimi që paraqet subjekti i rivlerësimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, nuk parashikohet në rastet specifike ligjore, sipas kërkesave të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012. Gjithashtu, Kolegji kryesisht vlerësoi se: a) konstatimi i gjendjes faktike është bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja; b) nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike të konstatuara gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni; c) nuk është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të administruara në Komision.

³ “Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

11.4 Kolegji, në konkluzion të arsyetimit të mësipërm, vlerësoi si të pabazuar në ligj kërkimin e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, ndaj vendosi të vijojë ta shqyrtojë çështjen në formën e gjykimit të zhvilluar në dhomë këshillimi, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Mbi shqyrtimin e shkaqeve të ankimit

Analizimi i shkaqeve procedurale të ankimit

12. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në Komisionin i është nënshtruar procesit të rivlerësimit bazuar vetëm në dy kriteret e vlerësimit, atë të figurës dhe të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, si dhe në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti pretendon se procesi i tij i rivlerësimit ka filluar në datën 12.11.2019 dhe ka përfunduar më datë 16.07.2020, proces i zhvilluar në një kohë të shpejtë, sipas tij. Subjekti argumenton se në datën 29.06.2020, nëpërmjet postës elektronike, i janë dërguar Komisionit shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, në të cilat është kërkuar riçelje e hetimit administrativ duke përfshirë edhe kriterin e vlerësimit të pasurisë, kërkesë e cila është refuzuar nga ana e Komisionit, duke i mohuar kështu procesin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret vlerësuese, që parashikon ligji nr. 84/2016.

12.1 Kolegji mori në analizë pretendimin e subjektit të rivlerësimit, nga i cili vëren se, duke iu referuar nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: *Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.* Pra, vendimi në procesin e rivlerësimit për subjektet e rivlerësimit, mund të merret bazuar në një ose disa prej kriterëve të rivlerësimit, që do të thotë se nëse në një moment të caktuar të zhvillimit të procedurës hetimore administrative nga ana e Komisionit, ky i fundit arrin në përfundimin se ekzistojnë shkaqe për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit bazuar në rezultatet e arritura nga procedura për vlerësimin edhe vetëm të një kriteri, ligji e lejon Komisionin të mbyllë procedurën e rivlerësimit për atë kriter, mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit, dhe të marrë një vendim për shkarkimin e subjektit, pa qenë e nevojshme që procedura administrative të vazhdojë më tej, me verifikimin e kriterëve të tjera.

12.2 Kur Komisioni çmon se provat kanë një nivel të tillë provueshmërie sipas parashikimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, lexuar në harmoni me nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, dhe sipas interpretimit logjik të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, që bëjnë të besohet se subjekti i rivlerësimit gjendet para prezumimit ligjor të vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, atëherë është e mundur vendimmarrja për një ose dy kriterë. Pavarësisht vendimit që mund të merret në këtë fazë, për të mbyllur hetimin administrativ mbështetur vetëm mbi një ose dy kriterë vlerësimi, Komisioni, në funksion të zhvillimit të një procesi të drejtë e në respektim të së drejtës së subjektit të rivlerësimit për t'u dëgjuar e mbrojtur, mundet ta revokojë këtë vendimmarrje pas kryerjes së seancës dëgjimore të analizës së pretendimeve të subjektit, krahas provave të administruara nga hetimi, dhe të vazhdojë procedurën hetimore administrative edhe për

komponentët e tjerë. Ndërkohë që parashikimi i nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 kërkon që, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Komisioni duhet detyrimisht të vlerësojë tri kriteret në mënyrë kumulative. Në nenin 59 të ligjit nr. 84/2016, është mirëpërcaktuar se, me qëllim konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, kërkohet që ai të plotësojë kushtet e kërkuara për tri kriteret, duke arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

12.3 Kolegji vëren se në funksion të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, del i qartë interpretimi që institucionet e rivlerësimit mund ta marrin vendimin mbi bazën e vlerësimit të një ose dy kriterëve, në vlerësimin e tri kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tyre, ose në vlerësimin tërësor të procedurave të një ose disa kriterëve të rivlerësimit, qëndrim ky i mbajtur në jurisprudencën⁴ e Kolegjit. Komisioni dhe Kolegji kanë të drejtë për të konkluduar me vendim, qoftë edhe vetëm për njërin nga kriteret dhe, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, konkretisht për kriterin e pasurisë, Kushtetuta parashikon shkarkimin nga detyra për ato raste të deklarimit të pasurisë të parashikuara në këtë dispozitë, siç është përpjekja për të fshehur apo paraqitja në mënyrë të pasaktë e pasurive. *Si rrjedhojë e sa më sipër, Kolegji çmon se shkak i ankimit i pretenduar nga subjekti i rivlerësimit nuk është i bazuar.*

13. Subjekti i rivlerësimit pretendon se i është drejtuar Komisionit me kërkesë për shtyrje të seancës dëgjimore për shkaqe shëndetësore. Subjekti referon se nga Komisioni i është caktuar seanca dëgjimore në datën 14.07.2020, në orën 12:00, seancë në të cilën për shkak të gjendjes shëndetësore, subjekti i rivlerësimit nuk është paraqitur dhe, në këto kushte, seanca publike ka vijuar pa praninë e tij. Subjekti argumenton se ka qenë në pamundësi kohore për shkak të periudhës së pandemisë dhe, duke mos ia pranuar shtyrjen e zhvillimit të gjykimit, nuk i është dhënë mundësia të shprehet, të japë shpjegimet e tij, duke qenë i pranishëm gjatë gjykimit. Subjekti ka pretenduar se procesi i tij i rivlerësimit ka vijuar vetëm shtatë muaj dhe, sipas tij, ka zgjatur pak krahasuar me subjektet e tjera të rivlerësimit.

13.1 Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se Komisioni më datë 30.06.2020, nëpërmjet postës elektronike, ka ftuar subjektin e rivlerësimit për t'u dëgjuar në seancën publike që do të zhvillohej më datë 03.07.2020, ora 12:00. Subjekti i rivlerësimit, më datë 03.07.2020, nëpërmjet postës elektronike, i ka kërkuar Komisionit t'i caktohet një seancë tjetër për shqyrtimin e çështjes së tij, pasi në orët e para të mëngjesit të së njëjtës datë, është paraqitur në Spitalin Rajonal të Gjirokastrës me probleme kardiake dhe, në vijim, subjekti do të paraqiste dokumentacionin justifikues që dëshmon për gjendjen e tij shëndetësore, dokument i cili nuk u depozitua nga subjekti në Komision. Në datën 06.07.2020, Komisioni i është drejtuar subjektit të rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike, duke e njoftuar se është ende në pritje të njoftimit nga subjekti lidhur me përcaktimin e datës së seancës publike, nisur dhe nga kërkesa e tij për shtyrjen e seancës. Në komunikimin elektronik, nuk rezulton që Komisioni t'i ketë sugjeruar ndonjë datë subjektit të rivlerësimit. Komisioni, më datë 07.07.2020, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit se

⁴ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 9/2018 (JR), paragrafi 44; nr. 11/2018 (JR), paragrafi 5; nr. 2/2019 (JR), paragrafi 35.2; nr. 15/2019 (JR), paragrafi 119; nr. 34/2019 (JR), paragrafi 55.1; nr. 20/2020, paragrafët 14.1, 14.2, 14.3.

seanca e ardhshme dëgjimore është caktuar në datën 14.07.2020, në orën 12:00. Subjekti i rivlerësimit rezulton se i është përgjigjur këtij *e-mail*-i në datën 07.07.2020, duke e njoftuar Komisionin se në datën 14.07.2020, e ka të pamundur të paraqitet në seancë dëgjimore për shkak të pamundësisë shëndetësore, duke e lënë në çmimin e Komisionit për vazhdimin ose jo të procesit të tij të rivlerësimit. Sipas dokumentacionit të administruar në dosjen e Komisionit, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë paraqitur ndonjë raport mjekësor për të justifikuar pamundësinë e tij për të qenë prezent në seancën dëgjimore, gjithashtu nuk ka dhënë një propozim konkret për datë seance, edhe pse një gjë e tillë iu mundësua nga Komisioni. Si rrjedhojë, Komisioni, me të drejtë, vendosi të vazhdojë seancën dëgjimore në datën 14.07.2020, pa praninë e subjektit të rivlerësimit.

13.2 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, trupi gjykues konstatoi se gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni e njohu subjektin e rivlerësimit me gjetjet paraprake pas shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit të marrë nga institucione të ndryshme. Ky informacion që subjekti i rivlerësimit mori pas përfundimit të hetimit administrativ, duhet t'i kishte mundësuar atij që të kuptonte seriozitetin e gjetjeve paraprake, me qëllim përgatitjen e mbrojtjes së përshtatshme sipas vlerësimit të gjendjes së tij shëndetësore. Pasi iu komunikuan nga Komisioni rezultatet e hetimit (02.06.2020), subjektit të rivlerësimit iu mundësua akses i në dokumentacionin e çështjes, për të cilin ka plotësuar deklaratën më datë 11.06.2020, që ky dokumentacion i është vënë subjektit në dispozicion. Sërisht subjekti kërkoi shtyrjen e afatit për dorëzimin e shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit të lënë nga Komisioni më datë 17.06.2020, për shkak të mosfunksionimit të linjave ndërqytetëse si rrjedhojë e situatës pandemike, kërkesë e cila u pranua nga Komisioni, duke shtyrë afatin e dorëzimit më datë 25.06.2020. Në vijim, subjekti i rivlerësimit kërkoi dy herë të shtyhet seanca dëgjimore për shkak të kushteve shëndetësore, kërkesë e cila ishte përsëritur dhe ishte e pashoqëruar me dokumentacion mjekësor, duke shfaqur kështu sjellje të cilat krijojnë bindjen se tentonte të zvarriste procesin e tij të rivlerësimit. Çdo subjekt rivlerësimi që i nënshtrohet këtij procesi sipas ligjit nr. 84/2016, ka të drejtën e tij për një hetim të pavarur, të paanshëm dhe një rivlerësim në përputhje me ligjin nga organet e rivlerësimit, pa pasur një përcaktim për kohëzgjatjen e këtij procesi. Në përfundim të analizës më sipër, Kolegji vlerësoi se sipas dokumentacionit të administruar në dosje, nuk evidentohet shkelje e procesit të rregullt nga Komisioni lidhur me procesin e rivlerësimit për subjektin Spartak Çoçoli, si rrjedhojë pretendimi i ngritur prej subjektit nëpërmjet këtij shkakut ankimi, nuk gjendet i bazuar.

Shkaqet e ankimit që lidhen me kontrollin e figurës

14. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se në procesin e tij të rivlerësimit në Komision, nuk është sqaruar se si në dy raportet e DSIK-së të datave 02.11.2017 dhe 28.03.2018, subjekti rezulton i përshtatshëm për të vazhduar detyrën, ndërsa në raportin e rishikuar nga DSIK-ja, të datës 10.03.2020, subjekti i rivlerësimit rezulton i papërshtatshëm për të vazhduar detyrën. Për të gjitha konstatimet e Komisionit, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk është informuar se në çfarë kushtesh janë kryer veprimet që i atribuohen subjektit sipas raportit të DSIK-së e më pas nga Komisioni, pasi nuk jepet asnjë e dhënë, përveçse është evidentuar se “ngrihen dyshime”.

Komisioni, konstatimet për kriterin e figurës i ka vlerësuar në tërësinë e çështjes, brenda përcaktimeve të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti argumenton se tërësia e çështjes ka të bëjë me konkluzionet që ka arritur Komisioni për kriterin e figurës, të shoqëruara me kriterin e aftësiwe profesionale, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit në veprimtarinë e tij, ka cenuar rëndë besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit në lidhje me komponentin e figurës, është i gabuar, pasi në asnjë rast, nga Komisioni, nuk vërtetohen dyshimet për përfshirjen në veprimtari të kundërligjshme korruptive, apo që subjekti të ketë pasur kontakte të papërshtatshme, si dhe gjetjet e Komisionit nuk u përkasin standardeve të përcaktuara nga neni 38, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

14.1 Konkluzionet e Komisionit për kriterin e figurës: *Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se konstatimi i DSIK-së për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës, nuk lidhet me saktësinë dhe vërtetësinë e plotësimit të deklaratës së figurës, pasi nga rrethanat e konstatuara nga Grupi i Punës së DSIK-së dhe nga Komisioni për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, nuk rezulton të ketë bërë deklaram të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të jetë në kushtet e nenit 61, pika 2 apo 3, të ligjit nr. 84/2016 dhe për këtë arsye vlerëson se ka kryer deklaram të saktë në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, por konstatimet e gjetura gjatë hetimit mund të vlerësohen në tërësi të çështjes lidhur me rivlerësimin e subjektit, z. Spartak Çoçoli, brenda përcaktimeve të tjera të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. [...] Rëndësia e integritetit të figurës së gjyqtarit apo prokurorit, duhet të qëndrojë në themel të procesit të rivlerësimit. Në këto kushte, konkluzionet e arritura gjatë hetimit të pastërtisë së figurës për z. Spartak Çoçoli, të ndërthurura me hetimin dhe vlerësimin e rasteve gjatë hetimit dhe vlerësimit profesional, vlerësohen se subjekti i rivlerësimit gjendet në situata të përsëritura në shkelje të ligjit, të cilat rëndojnë pozitën e tij si prokuror dhe kanë për qëllim anësi në vendimmarrjet e tij lidhur me pushim të hetimeve si të pabazuar në ligj dhe në prova. Këto veprime, të vlerësuara në tërësinë e tyre, cenojnë rëndë besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, në kuptim të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

14.2 Kolegji vëren se DSIK-ja ka dërguar raportin me nr. {***} prot., datë 02.11.2017, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Spartak Çoçoli, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së këtij subjekti. Menjëherë pas shortimit të subjektit të rivlerësimit, Komisioni i ka kërkuar DSIK-së rifreskim dhe përditësim informacioni. DSIK-ja përcjell në Komision raportin me nr. {***} prot., datë 09.03.2020, të deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 09.03.2020, të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit (në vijim “KDZh”), sipas të cilit ka vlerësuar për papërshtatshmërinë për vijimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Spartak Çoçoli. Grupi i punës pranë DSIK-së, bazuar në shkronjat “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, ka raportuar se veprimtaria korruptive e subjektit të rivlerësimit, në bashkëpunim, cenon drejtpërsëdrejti pastërtinë e figurës, si dhe vlerësohet si individ që mund të vihet nën presion nga strukturat kriminale, duke ndryshuar kështu konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri në papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës. Ky raport argumenton se, mbështetur në të dhënat që disponon ky institucion, aktualitetin e tyre, si dhe

kohëzgjatjen më shumë se një herë dhe të shtrirë vazhdimisht në kohë, të përfshirjes apo implikimit në veprimtari të kundërligjshme, e gjen subjektin e rivlerësimit në papajtueshmëri të plotë me ushtrimin e detyrës së tij funksionale. Nisur nga informacioni i autoriteteve verifikuese, Komisioni, bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, analizoi provat e administruara për të cilat dyshohej se subjekti i rivlerësimit, gjatë ushtrimit të detyrës, mund të kishte favorizuar persona të proceduar penalisht.

14.3 Kolegji vëren se në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezultoi se: “Për subjektin e rivlerësimit ngrihen dyshime të arsyeshme për përfshirjen në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e korrupsionit pasiv të prokurorit në një çështje penale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Ka dyshime se subjekti kundrejt mitës ka favorizuar një individ të proceduar penalisht për moskallëzim krimi dhe një individ të proceduar penalisht për dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit. Subjekti ka favorizuar një person për mbylljen e çështjeve në hetim. Për subjektin ka dyshime se familjarë të disa të akuzuarve për vepra të ndryshme penale i kanë dhënë mitë prokurorit të çështjes. Subjekti i rivlerësimit është marrë i pandehur për veprën e parashikuar nga neni 313/ç i Kodit Penal dhe aktualisht po gjykohet për këtë veprë. Subjekti ka kryer një procedim jo të plotë në fazën e hetimeve paraprake në lidhje me procedimin penal për veprën penale të mospagimit të detyrimeve në ngarkim të një individi administrator i një shoqërie tregtare. Ka dyshime se subjekti është i përfshirë në veprimtari në formën e ndërveprimit korruptiv lidhur me ekzekutimin e një vendimi gjyqësor. Subjekti ka mundësuar lehtësimin e pozitës së një të pandehuri nëpërmjet dhënies së masës së arrestit “detyrim paraqitjeje”. Komisioni, në përfundim të verifikimeve lidhur me vlerësimin e figurës, i kalon subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të paraqitur prova e për të dhënë shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën në lidhje me konstatimet e mësipërme”.

14.4 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e datës 29.06.2020, mbi rezultatet e hetimit, ka sqaruar se: “Nga ana e DSIK-së, më datë 02.11.2017, është dërguar raporti përkatës mbi kontrollin e figurës, duke konstatuar se subjekti i rivlerësimit është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës. Në vazhdim, në datën 28.03.2018, nga ana e DSIK-së ju dërgohet i njëjti konstatim se subjekti i rivlerësimit është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës. Në datën 10.03.2020, DSIK-ja përcjell raportin e rishikuar, ku në këtë raport në mënyrë të çuditshme, grupi i punës konstaton papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës nga ana e subjektit të rivlerësimit. [...] Rezulton se ka pasur një kallëzim penal nr. {***} nga një individ, me pretendimin se prokurori Spartak Çoçoli dhe A. Z. kanë kërkuar para. Në lidhje me këtë material kallëzues, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin e datës 07.07.2015, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Në këtë material kallëzues, rezulton të mos ketë elemente të ndonjë vepre penale”.

14.5 Nisur nga të dhënat e raportit të DSIK-së, Komisioni i ka kërkuar⁵ Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar informacionet që ata disponojnë mbi procedimet

⁵ Me shkresën nr. {***} prot., datë 06.02.2020.

penale në ngarkim të subjektit të rivlerësimit. Kjo prokurori ka informuar⁶ se Prokuroria për Krimet e Rënda Tiranë, më datë 14.01.2019, ka regjistruar procedimin penal nr. {***} në ngarkim të personave: (1) Spartak Çoçoli, i dyshuar për veprën penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal; (2) E. D., i dyshuar për veprën penale “Korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 319 dhe 25 të Kodit Penal; (3) E. H., i dyshuar për veprën penale “Korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 319 dhe 25 të Kodit Penal.

14.6 Kolegji vëren se në informacionin referues, në fashikullin penal të administruar në dosjen e Komisionit, rezulton se dy personat e cituar në paragrafin më sipër, njëri kallëzues dhe tjetri i kallëzuar, ku këtij të fundit i ishte sekuestruar një automjet nga Policia Gjyqësore Tepelenë, u është referuar çështja për veprën penale të “Kanosjes”, parashikuar nga neni 84 i K. Penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë. Dy personat po bënin marrëveshje mes tyre për mbylljen e rastit të kallëzuar në Prokurori dhe nxjerrjen e makinës së sekuestruar kundrejt një përfitimi të padrejtë që do i jepnin prokurorit të çështjes Spartak Çoçoli. Nga hetimet e kryera nga Prokuroria për Krime të Rënda, është krijuar dyshimi i arsyeshëm, bazuar në prova, se prokurori Spartak Çoçoli ka kërkuar një përfitim të padrejtë në këmbim të një veprimi që do të kryente në kuadër të detyrës si prokuror, pra të kthimit të sendit të sekuestruar. Në datën 14.01.2019, është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal nr. {***}, për veprat penale të “Korrupsionit aktiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, si dhe “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve, dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319 dhe 319/ç i Kodit Penal. Gjithashtu, më datë 14.01.2019, është urdhëruar edhe regjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale si person nën hetim, subjektit të rivlerësimit Spartak Çoçoli, pasi dyshohet për veprën penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal. Më datë 21.06.2019, subjektit të rivlerësimit i është njoftuar akuza nga Prokuroria për Krime të Rënda.

14.7 Referuar pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, ku jepet përkufizim për individët e përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të këtij ligji, sipas të cilit është i përfshirë në krimin e organizuar çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht për veprat e parashikuara në nenin 3, pika 1 e ligjit nr. 10192, trupi gjykues vëren se vepra (neni 319/ç i K.Penal) për të cilën është proceduar subjekti i rivlerësimit, bën pjesë në rrethin e veprave të parashikuara nga ky ligj (shtuar me ligjin 24/2014⁷), që e bën subjektin e rivlerësimit individ të përfshirë në krimin e organizuar. Veprimtaria e paligjshme e korrupsionit pasiv të prokurorit i përmbahet përcaktimit të pikës 8 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, që përfshin veprat penale që parashikohen në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, ku përfshihen “Krimi i organizuar, trafikimi dhe korrupsioni” dhe se kjo marrëdhënie evidenton rrethanat e konstatimit të faktit se ekzistojnë kontakte të papërshtatshme sipas përcaktimit të pikës

⁶ Me shkresën nr. {***} prot., datë 17.02.2020.

⁷ Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

6 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Qëllimi dhe fryma e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me kontrollin e figurës, kërkon që procesi i rivlerësimit të identifikojë gjyqtarët e prokurorët, të cilët kanë integritet të cenuar, duke i përjashtuar ata nga sistemi i drejtësisë. Ligji, duke urdhëruar verifikimin, nëse subjektet kanë kontakte të papërshtatshme, nuk mund të përjashtojë verifikimin e figurës së vetë subjektit të rivlerësimit, nëse ka dyshime të bazuara se ai është përfshirë në krimin e organizuar, sipas pikës 8 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, konkretisht korrupsion pasiv.

14.8 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, Kolegji vëren se me vendimin nr. {***}, datë 24.01.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, është caktuar ndaj subjektit të rivlerësimit masa e sigurimit personal “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, si dhe masa e sigurimit personal me karakter ndalues “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”, parashikuar nga neni 242 i K.Pr.Penale. Në datën 08.07.2019, prokurorja e çështjes ka paraqitur kërkesën për gjykimin e çështjes penale nr. {***} të vitit 2019, ku një nga të pandehurit është edhe subjekti i rivlerësimit. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 30.10.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit për dërgimin në gjykim të çështjes penale që i përket subjektit të rivlerësimit të akuzuar për veprën penale të korrupsionit pasiv. Kolegji konstatoi se vepra penale për të cilën është akuzuar subjekti i rivlerësimit, bën pjesë në rrethin e veprave që përfshin neni 75/a i K. Penal.

14.9 Kolegji vëren se nga informacioni⁸ i përcjellë në Komision nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, rezulton se kjo çështje gjykohet me procedurë gjykimi të shkurtuar. KLP-ja, me vendimin nr. {***}, datë 16.07.2019, bazuar në nenin 148/d, pika 4, shkronja “b”⁹ e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka vendosur pezullimin e statusit të prokurorit Spartak Çoçoli për shkak të marrjes së statusit si i pandehur. Komisioni, lidhur me këtë procedim penal, nuk ka arritur në konkluzion për shkak të informacionit zyrtar të sipërcituar, se çështja nuk ka përfunduar dhe është në gjykim. Procedimin penal dhe marrjen e subjektit të rivlerësimit në cilësinë e të pandehurit për veprën penale të parashikuar në nenin 319/ç të Kodit Penal, Komisioni nuk e ka kualifikuar sipas përcaktimeve të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, për të konkluduar sipas nenit 61, pika 2 e këtij ligji, por e ka kualifikuar këtë situatë faktike si cenim të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Kolegji sjell në vëmendje se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion që të përmbajë informacion për ecurinë e gjykimit, nga momenti që ankimi i tij është regjistruar në Kolegj.

14.10 Kolegji, bazuar në informacionet nga burime të hapura, është vënë në dijeni për fakte dhe rrethana të publikuara, nga të cilat rezulton se çështja në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, ka përfunduar në Gjykatën e Posaçme Kundër Krimit dhe Korrupsionit, Tiranë, dhe kjo e fundit, për subjektin e rivlerësimit, ka vendosur fajësinë për veprën penale të korrupsionit pasiv, parashikuar nga neni 319/ç i K. Penal. Në këtë material përshkruhet se z. Çoçoli është dënuar me 2 vite burgim, të cilat i janë konvertuar me 4 vite shërbim prove. Në vijim të sa më sipër, Komisioni ka konstatuar

⁸ Me shkresën nr. {***} prot., datë 17.02.2020.

⁹ “Prokurori pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë kur: [...] b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje”.

gjendjen faktike deri në marrjen e informacionit se çështja është në fazë gjykimi. Lidhur me këtë konstatim, në Kolegj nuk ka informacion zyrtar nëse vendimi është përfundimtar dhe nuk është ankimuar në shkallët më të larta të gjyqësorit. Në këto kushte, ku informacioni zyrtar¹⁰ që disponohet në Kolegj vërteton që çështja është në fazë gjykimi, trupi gjykues vlerëson se situata ligjore dhe faktike, ku subjekti i rivlerësimit është proceduar penalisht për një veprë penale që përfshihet në rrethin e veprave të parashikuara nga neni 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, por në vlerësimin tërësor, çojnë në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

14.11 Me shkresën nr. {***} prot., datë 17.02.2020, përcjellë nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në përgjigje të shkresës nr. {***} prot., datë 06.02.2020, të Komisionit, informohet se nga të dhënat e nxjerra nga arkiva pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit, ka pasur një kallëzim tjetër penal, i regjistruar me nr. {***}, kallëzuar nga individi F. K. në portalin *online* të Ministrisë së Drejtësisë “Stop korrupsionit”, i cili ka pretenduar se prokurorët Spartak Çoçoli dhe A. Z. i kanë kërkuar para në shkëmbim të rrethanave favorizuese. Sipas kësaj ankese, ky individ ka blerë një automjet nga një person tjetër, i cili më pas i është sekuestruar nga sektori i antitrafikut në Drejtorinë e Policisë, Qarku Fier, sepse ka rezultuar i vjedhur. Në këto rrethana, ka filluar procedimi penal nga Prokuroria e Fierit për veprën penale “Trafikimi i mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a i K. Penal. Individit F. K. i është sekuestruar dokumentacioni i automjetit dhe nuk i është kthyer, dhe ky është themeli i ankesës së tij.

Në ankesën e tij, z. K. i shprehet se po i mbahej dokumentacioni i mjetit kundrejt përfitimit të paligjshëm nga disa prokurorë, ku ka përmendur edhe emrin e subjektit të rivlerësimit. Në fashikullin penal të procedimit të filluar për veprën penale të trafikimit të mjeteve motorike, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë qenë prokurori i çështjes, por rezulton se ka lëshuar urdhrin pa datë, të vitit 2013, për heqjen e automjetit nga ruajtja në parkimin e Drejtorisë së Policisë Durrës dhe lënien në ruajtje personit B. B. Sipas procesverbalit të datës 03.06.2015, nga personat që tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit, z. F. K. nuk ka deklaruar apo pretenduar se subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar para, madje nuk e ka përmendur fare emrin e tij apo ndonjë akuzë lidhur me të, por ai ka deklaruar se shoferi i Prokurorit të Rrethit Gjrokastër, z. A. P., i ka kërkuar shumën 2.000 euro, por që e ka takuar vetëm një herë shoferin, citon kallëzuesi.

Komisioni, lidhur me këtë çështje, vlerësoi se, referuar standardit të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit nuk i atribuohet asnjë kontakt i çfarëdo lloji me subjekte që janë përfshirë apo dyshohen si pjesëtarë të strukturave të organizuara kriminale, por konstatimet e gjetura gjatë hetimit, i vlerësoi në tërësi të çështjes lidhur me rivlerësimin e subjektit Spartak Çoçoli, sipas përcaktimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

14.12 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka disponuar në vendimin e mosfillimit, se procedimi penal nuk mund të fillojë pasi faktet e pretenduara nuk parashikohen

¹⁰ Sipas informacionit të përcjellë nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me shkresën nr. {***} prot., datë 17.02.2020, rezulton se kjo çështje gjykohet me procedurë gjykimi të shkurtuar.

nga ligji si vepër penale, bazuar në nenin 290/1, shkronja “ç” dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale. Mosfillimi i këtij kallëzimi penal është vendosur në datën 07.07.2015.

Neni 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016 përcakton se: *“Person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur:*

- a) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet;*
- b) deklarohet i pafajshëm nga gjykata pasi vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet.*

14.13 Kolegji vëren se në kuptim të dispozitave procedurale penale, statusin e personit të proceduar penalisht e merr individi, të cilit i regjistrohet emri në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, në zbatim të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, sipas normave procedurale në këtë moment, personi merr cilësinë e personit të dyshuar për kryerjen e një veprë penale dhe, ndaj tij, zbatohen të gjitha dispozitat që zbatohen edhe për të pandehurin në një procedim penal, sipas nenit 34 të Kodit të Procedurës Penale. Në rastin konkret, ndaj subjektit të rivlerësimit, nuk rezulton të jetë regjistruar procedim penal dhe as të jenë kryer hetime paraprake, përveçse është administruar deklarata e individit F. K., si person që tregon rrethana të dobishme për qëllime të hetimit, tek e cila nuk ka cituar më dhe akuzuar subjektin e rivlerësimit t’i ketë kërkuar para për qëllime favorizimi rrethanash. Si rrjedhojë, nuk jemi në kushtet e nenit 287 të K.Pr.Penale. Për subjektin e rivlerësimit, është vendosur mosfillimi i procedimit penal, pra nuk ka filluar një procedim penal, nuk ka vepër penale të regjistruar dhe as person të cilit i atribuohet vepra penale.

14.14 Të dhënat për një vepër penale verifikohen me qëllim që të konkludohet drejt nëse fakti konkret parashikohet si vepër penale dhe nëse autori i saj është i përgjegjshëm penalisht. Kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, konstatimi i rrethanave bëhet para fillimit të procedimit penal. Mjafton që fakti i dhënë të përballet me Kodin Penal për të konkluduar nëse ai përbën vepër penale. Sipas praktikës së Gjykatës së Lartë¹¹, neni 290 i K.P.Penale parashikon rrethanat kur procedimi nuk mund të fillojë, apo në qoftë se ka filluar, duhet të pushojë, rrethana këto që sipas paragrafëve të kësaj dispozite, lidhen me veprën penale, ose me autorin që e ka kryer atë. Në këtë rast, prokuroria, duke iu referuar shkronjës “ç” të pikës 1 të kësaj dispozite, e ka lidhur mosfillimin me vetë ekzistencën e veprës penale, që në rastin konkret nuk ekziston. Që prokuroria të arrinte në këtë përfundim pa filluar çështja penale, për pasojë pa kryer hetime që lidhen me sa i referohet, duhet të konstatohet që fakti i kallëzuar nuk parashikohet si vepër penale nga Kodi Penal.

Neni 290 i K.Pr.Penale, “Rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit”:

- 1. Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe, në qoftë se ka filluar, duhet të pushojë në çdo gjendje të procedimit, kur:*
 - a) personi ka vdekur;*

¹¹ Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 65, datë 30.01.2002.

- b) personi është i papërgjegjshëm ose nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale;
- c) mungon ankimi i të dëmtuarit ose ai e tërheq ankimin;
- ç) **kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale** ose kur del qartë që fakti nuk ekziston;
- d) vepra penale është shuar;
- dh) është dhënë amnisti;
- e) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 291 i K.Pr.Penale, “Vendimi për mosfillimin e procedimit”:

1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit.
2. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, të cilët mund ta kundërshtojnë atë në gjykatë, brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit.

14.15 Kolegji sjell në vëmendje vendimin unifikues nr. 2, datë 20.06.2013, të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit procedimi penal merr shkas nga njoftimi që merr prokurori kryesisht apo nga policia gjyqësore, por edhe nga kallëzimi i individëve apo personave juridikë për ngjarjen e një vepre penale. Prokurori regjistron procedimin penal fillimisht për veprën që ai ka marrë njoftim se është kryer e, sipas rastit, edhe emrin e personit që i atribuohet vepra penale. Është pikërisht ky momenti që prokurori ka mundësi të verifikojë nëse ndodhemi para rasteve të parashikuara prej nenit 290 të Kodit të Procedurës Penale, pra nëse ndodhemi përpara rrethanave që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal dhe që legjitimojnë marrjen e vendimit mbi mosfillimin e procedimit penal. Vendimi i prokurorit që ka disponuar mosfillimin, merret pasi më parë, janë verifikuar rrethanat e parashikuara nga neni 290 i K.Pr.Penale. Këto rrethana, në fakt, nuk kërkojnë një proces të ndërlikuar e të gjatë për mbledhjen e të dhënave apo të kryerjes së veprimeve të rëndësishme hetimore në drejtim të zbulimit të fakteve lidhur me themelin e fajësisë apo të pafajësisë.

14.16 Për sa më sipër, trupi gjykues vëren se në rastin e mosfillimit të procedimit penal, ligji ka parasysh mungesën e elementeve që përbëjnë figurën e veprës penale. Pikërisht anën objektive të figurës së krimit ose kundërvajtjes penale të pretenduar. Veprimet e personit vërtet mund të jenë të kundërligjshme, por ato nuk janë të dënueshme penalisht e të parashikuara nga dispozitat e Kodit Penal, por mund të zgjidhen nga dispozitat e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile ose Administrative. Pra, që të jemi para rrethanës që nuk lejon fillimin e procedimit penal, duhet që nga perceptimi i faktit të pretenduar, të mos ekzistojë dyshimi se ky fakt i përgjigjet ekzistencës së një figure vepre konkrete të parashikuar nga K.Penal. Që të arrihet në konkluzionin se fakti i pretenduar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, nuk ka nevojë për zhvillimin e hetimeve, nga e cila rrjedh se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e pushimit të procedimit penal ku hetimet kanë filluar dhe për arsyet e për ligjura janë pushuar, por subjekti ndodhet në kushtet e mosfillimit të çështjes penale për të cilën nuk janë identifikuar elemente të veprës penale dhe, si i tillë, nuk përbën kontakt të papërshtatshëm në kuptim të nenit 3, pikat 8 dhe 15 të ligjit nr. 84/2016. Si rrjedhojë e sa më sipër, Kolegji vëren se meqenëse veprimet e subjektit të rivlerësimit nuk përkojnë me elemente të veprave penale të parashikuara nga Kodi Penal, vendimi i mosfillimit të procedimit penal në rastin kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, barazohet me vendimin e pafajësisë dhe, si i tillë, nuk mund të kualifikohet as sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr.

84/2016, duke e bërë vendimmarrjen e Komisionit të cenueshme dhe të padrejtë lidhur me këtë shkak ankimi.

Shkaqet e ankimit që lidhen me vlerësimin e aftësive profesionale

15. Subjekti i rivlerësimit pretendon se gjetjet e trupit gjykues të Komisionit për analizimin e aftësive profesionale, janë të pabazuara dhe subjektive. Në këtë vendim, Komisioni nuk ka trajtuar thelbin e një akti procedural që është vendimmarrja. Në asnjë prej akteve procedurale të vëzhguara nga ana e Komisionit, nuk evidentohet nëse vendimet e marra kanë qenë të drejta apo jo. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka pasur mangësi në përpilimin e akteve procedurale për periudhën kohore 2014 e në vazhdim, që ka ardhur si pasojë e mospërqendrimit në punë për shkak të problemeve familjare, si pasojë e divorcit të ndodhur në vitin 2014. Subjekti i rivlerësimit argumenton në ankim se ka një karrierë 27-vjeçare në sistemin e drejtësisë dhe mangësitë e vogla të konstatuara në aftësitë profesionale në vendimin e Komisionit, kanë qenë gjuha joprofesionale në përpilimin e akteve procedurale, e cila nuk mund të përbëjë element të papërshtatshmërisë së aftësive profesionale dhe aq më pak që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Në përfundim të shkakut të ankimit, subjekti i rivlerësimit pretendon se nëpërmjet provave të administruara, si dhe shpjegimeve të tij, arrin nivel besueshmërie në vlerësimin e pasurisë dhe në kontrollin e figurës, ndërsa sa u përket aftësive profesionale, i kërkon trupit gjykues të Kolegjit aplikimin për subjektin të “Pezullimit nga detyra dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit”, sipas nenit 60 të ligjit nr. 84/2016, dhe jo aplikimin e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 që parashikon “Shkarkimin nga detyra” për subjektin e rivlerësimit.

15.1 Konkluzionet e Komisionit për kriterin e aftësive profesionale: *Trupi gjykues vlerëson se në rastet kur gabimet e subjekteve të rivlerësimit evidentohen që përsëriten në mënyrë të vazhdueshme dhe në praktika të ndryshme, përbëjnë përjashtim nga rastet e konfirmimit në detyrë dhe ato duhet të vlerësohen negativisht. Në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, si dhe nuk ka respektuar të drejtat e palëve, ndaj ai konsiderohet “i papërshtatshëm”, pasi mangësitë vlerësohen të tilla që nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, pasi rezulton i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale.*

15.2 Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni, është bazuar në: (i) raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLP-ja, i cili përfshin vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në tri dokumente ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti, pesë dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe në të dhënat nga burimet arkivore të KLP-së; (ii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, (në vijim “ligji nr. 96/2016”); (iii) denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

15.3 Për shkak të vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkëngjitur formularit të vetëvlerësimit profesional, tri dokumente ligjore, dy prej të cilave rezultuan me probleme dhe konkretisht: (i) **Diskutim përfundimtar**, marrë në kuadër të procedimit

penal nr. {***}, për veprën penale të “Vjedhjes”, parashikuar nga neni 134, paragrafët 3 dhe 25 të K.Penal; (ii) **Kërkesë për gjykim**, marrë në kuadër të procedimit penal nr. {***}, për veprën penale “Goditje për shkak të detyrës”, parashikuar nga nenet 237 dhe 25 të K.Penal. Subjekti i rivlerësimit në ankim nuk ka ngritur shkaqe me detaje specifike për të realizuar mbrojtjen, nëpërmjet ankimit, për procedimet penale, por nga Kolegji, janë vlerësuar konkluzionet e Komisionit nëse janë të drejta lidhur me procedimet penale, për të cilat është kryer vlerësimi i aftësive profesionale, si vijon.

15.4 Dokumenti “Diskutim përfundimtar”, që i përket procedimit penal nr. {*}**, për veprën penale të “Vjedhjes”, parashikuar nga neni 134, paragrafë 3 dhe 25 të K.Penal, në ngarkim të të pandehurve A. B., F. Z., E. Sh. dhe E. B.. Procedimi penal ka filluar për të pandehurit e cituar më sipër, si dhe E. B.. Çështja penale në ngarkim të të pandehurit E. B., bashkautor i kësaj vepre penale, është gjykuar më vete dhe është deklaruar fajtor nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër për veprën penale të “Vjedhjes”, kryer në bashkëpunim, vepër kjo e parashikuar nga neni 134, paragrafët 3 dhe 25 të K.Penal. Ky i fundit ka pranuar fajësinë dhe ka treguar se ka kryer këtë vjedhje së bashku me të pandehurit e tjerë, cituar në fjalinë e parë të këtij paragrafi, duke shpjeguar në mënyrë të detajuar mekanizmin e ngjarjes për kryerjen e veprës penale. Në përfundim të dokumentit “Diskutim përfundimtar”, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurve A. B., F. Z., E. Sh. dhe E. B. për veprën penale të “Vjedhjes”, parashikuar nga neni 134, paragrafët 3 dhe 25 të K.Penal dhe dënimin e tyre me 10 vjet burgim.

15.4.1 Komisioni, nga përmbajtja e aktit procedural “Diskutim përfundimtar”, ka konstatuar se subjekti nuk ka analizuar rrethanat e faktit penal, elementet e veprës penale, si dhe rrethanat rënduese apo lehtësuese që e kanë shtyrë subjektin e rivlerësimit të arrinte në konkluzionin për masën e dënimit prej dhjetë vitesh për secilin të pandehur; subjekti nuk analizon asnjë provë të administruar gjatë gjykimit; subjekti i rivlerësimit nuk ka arsyetuar shkaqet ligjore të disponimit të tij mbi masën e dënimit. Lidhur me këto konstatime, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë shpjegime dhe paraqitur prova për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

15.4.2 Kolegji vëren se në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit të dërguara në Komision më datë 29.06.2020 në rrugë elektronike, subjekti i rivlerësimit, lidhur me barrën e provës, ka sqaruar: “Në raportin tuaj rezulton se nuk jeni marrë me thelbin e një akti procedural, që është vendimmarrja. Në asnjë prej akteve procedurale të vëzhguara nga ana juaj, nuk evidentohet nëse vendimet e marra kanë qenë të drejta apo jo. Për këtë fakt, kërkoj nga trupi gjykues, si dhe grupi i punës që ka hartuar raportin, që të më jepet një përgjigje nëse vendimmarrja në këto akte ligjore ka qenë e drejtë apo jo. Theksoj se kam pasur mangësi në përpilimin e akteve procedurale për periudhën kohore 2014 e në vazhdim, që ka ardhur si pasojë e mosqëndrimit në punë, për shkak të problemeve familjare të shkaktuara si pasojë e divorcit të ndodhur në vitin 2014 [...]”. Duket se subjekti i rivlerësimit, sa i përket citimit më sipër, në përgjigje të rezultateve të hetimit, është përgjigjur për vlerësimin e aftësive profesionale në tërësi, pa sjellë detaje dhe dokumente lidhur me kundërshtimin e konstatimeve të Komisionit apo barrës së provës lidhur me këtë procedim penal në veçanti.

15.4.3 Lidhur me përmbajtjen e aktit procedural “Diskutim përfundimtar”, KLP-ja ka konstatuar se nuk janë respektuar rregullat e drejtshkrimit. Dokumenti nuk është ndërtuar sipas standardit të akteve të kësaj natyre, pasi në të mungojnë tërësisht rrethanat e faktit penal, mungon pjesa përshkruese-argumentuese dhe subjekti i rivlerësimit përfundon me dispozitivin për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. KLP-ja citon në raportin e saj lidhur me këtë dokument: “Akti shpalos, por nuk analizon asnjë provë të administruar gjatë gjykimit”. Subjekti i rivlerësimit nuk ka arsyetuar shkaqet ligjore të disponimit të tij mbi masën e dënimit. KLP-ja vlerësoi se në akt, jo vetëm nuk janë analizuar elementet e veprës penale, por nuk është analizuar asnjë rrethanë rënduese apo lehtësuese që ka shtyrë subjektin e rivlerësimit të arrihte në konkluzionin për masën e dënimit prej dhjetë vitesh për secilin të pandehur. Dokumenti ligjor nuk mban asnjë datë, mban nënshkrimin e subjektit të rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes.

15.4.4 Trupi gjykues, për sa më sipër, lidhur me aktin procedural “Diskutime përfundimtare”, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit shkruan me gabime drejtshkrimore, të cilat janë mjaft të shpeshta në tekstin e këtij dokumenti (vërehet që ka edhe shkronja që nuk i përmban alfabeti shqip, si p.sh. “e” me theks lart, në vend të shkronjës “ë”). Përpos këtij fakti, në dokument janë cituar dhe përshkruar provat të cilat janë administruar në fashikullin penal, por nuk janë analizuar dhe argumentuar se çfarë është provuar me to, si kanë shërbyer për të vërtetuar kryerjen e veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij, që do të thotë se në këtë rast, duheshin analizuar elementet e veprës penale, pa analizën e të cilave nuk mund të arrihet në konkluzionin që një i akuzuar ka kryer veprën penale.

15.4.5 Lidhur me argumentin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka gjykuar nëse vendimmarrjet kanë qenë të drejta ose jo, Kolegji vlerësoi se në frymën e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, aftësitë profesionale të prokurorit duhen vlerësuar pa gjykuar në raport me korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet. Aspekti i arsytimit ligjor të prokurorit në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, vlerësohet bazuar në tregues si qartësia dhe kuptueshmëria e akteve, cilësia e analizës dhe argumentimi logjik. Gjithashtu, bazuar në sa u tha më sipër lidhur me këtë procedim penal, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka argumentuar kërkimin e dënimit maksimal që parashikon vepra penale e kryer nga të pandehurit, duke mos marrë parasysh parimin e individualizimit të dënimit, si një nga parimet bazë në luftën kundër personave që kryejnë vepra penale. Lloji dhe masa e dënimit duhet të kërkohet për një autor të veprës penale, duke vlerësuar shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, si dhe të autorit të saj, duke marrë në konsideratë edhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga nenet 48, 49 dhe 50 të K.Penal, gjë që subjekti nuk ka analizuar përse e ka konsideruar të përshtatshme masën që ka kërkuar, duke mbajtur parasysh rëndësinë e karakterin e veprës penale, personalitetin e të gjykuarve, rrethanat rënduese që kanë ndikuar në kërkimin e tij në dokumentin “Diskutime përfundimtare”.

15.4.6 Në përfundim të analizimit të këtij procedimi penal, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit, pas citimit të provave në dokumentin “Diskutim përfundimtar”, ka arritur në konkluzionin për masën maksimale (10 vjet) të dënimit të përcaktuar për veprën penale të parashikuar nga neni 134, paragrafi 3 i K.Penal, pa marrë në analizë përse të akuzuarit duhet të marrin dënimin maksimal, çfarë rrezikshmërie shoqërore paraqesin, aq më tepër në një fazë që ishte çështja, në përfundim të gjyqimit, ku mendohet se ekziston edhe qartësia për rrethanat e kryerjes së veprës penale, kryesisht për anën subjektive dhe objektive që shpalos mënyrën si është kryer, duke nxjerrë në pah edhe subjektin e veprës penale dhe rrezikshmërinë e tij shoqërore. Mangësia e një arsytimi të tillë, të domosdoshëm për një akt prokurori, bën të duket se subjekti i rivlerësimit, me qëndrimin e tij, nuk ka demonstruar njohuri ligjore, si një nga bazat e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas të cilave aspekti i arsytimit ligjor të prokurorëve në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë, si qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, cilësia e analizës dhe argumentimi logjik i prokurorit, duke shkelur kështu kërkesat e nenit 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016. Sa më sipër, konstatimet e Komisionit për këtë procedim penal, janë të drejta dhe të bazuara në ligj.

15.5 Dokumenti “Kërkesë për gjykim”, i cili është përgatitur nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të procedimit penal nr. {***}, regjistruar për veprën penale “Goditje për shkak të detyrës”, parashikuar nga nenet 237 dhe 25 të K.Penal, me të pandehur D. K. dhe K. H., është zgjedhur nga subjekti i rivlerësimit për t’ia nënshtruar vlerësimit të aftësive profesionale. Ky procedim penal është hetuar nga subjekti i rivlerësimit, për të cilin ka kërkuar gjykimin e tij në ngarkim të të pandehurve D. K. dhe K. H., akuzuar për veprën penale “Goditje për shkak të detyrës”, parashikuar nga nenet 237 dhe 25 të K.Penal.

15.5.1 Kolegji vëren se Komisioni, nga përmbajtja e aktit procedural “kërkesë për gjykim”, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit rezulton se nuk ka analizuar provat e kësaj çështjeje në kërkesën e tij për gjykim; subjekti rezulton se nuk ka përmendur në arsytim normat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Lidhur me këto konstatime, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime dhe paraqitur prova për të provuar të kundërtën e tyre.

15.5.2 Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit të dërguara në Komision më datë 29.06.2020, në rrugë elektronike, subjekti i rivlerësimit, lidhur me barrën e provës, ka sqaruar në të njëjtën mënyrë për kriterin e aftësive profesionale, si në paragrafin 15.4.2 më sipër, se: *Në raportin tuaj rezulton se nuk jeni marrë me thelbin e një akti procedural, që është vendimmarrja. Në asnjë prej akteve procedurale të vëzhguara nga ana juaj, nuk evidentohet nëse vendimet e marra kanë qenë të drejta apo jo. Për këtë fakt, kërkoj nga trupi gjykues, si dhe grupi i punës që ka hartuar raportin, të më jepet një përgjigje nëse vendimmarrja në këto akte ligjore, ka qenë e drejtë apo jo. Theksoj se kam pasur mangësi në përpilimin e akteve procedurale për periudhën kohore 2014 e në vazhdim, që ka ardhur si pasojë e mosqëndrimit në punë, nga problemet familjare të shkaktuara si pasojë e divorcit, të ndodhur në vitin 2014.*

15.5.3 Kolegji vëren se në raportin e KLP-së, lidhur me përmbajtjen e aktit procedural “Kërkesë për gjykim”, është konstatuar se në *pjesën hyrëse*, subjekti i rivlerësimit përshkruan subjektin që parashtron kërkesën, vendin dhe kohën e përpilimit të dokumentit ligjor, emërtimin e dokumentit dhe subjektin që i drejtohet kërkesa. Ndërsa *pjesa arsyetuese* është përbërë nga një pjesë. Përgjithësisht parashtrohet fakti penal, por mënyra e narratimit të faktit penal nuk është në standardet e tipologjisë së dokumentit ligjor “Kërkesë për gjykim”. Në këtë pjesë parashtrohet vepra penale, për të cilën akuzohen të pandehurit dhe konkluzioni i prokurorit për konsumimin e veprës penale nga i pandehuri. Në këtë raport, sqarohet se subjekti i rivlerësimit nuk shprehet se si ka arritur në konkluzionin se të dy të pandehurit kanë konsumuar veprat penale për të cilat akuzohen, nuk shpalosen provat apo burimet e provave që e kanë shtyrë subjektin e rivlerësimit të gjykojë mbi veprimet e jashtëligjshme të ndërmarra nga ana e të pandehurve.

15.5.4 Sa më sipër, lidhur me aktin “kërkesë për gjykim”, Kolegji konstatoi se teksti nuk përmban referenca ligjore. Dokumenti paraqitet i strukturuar në mënyrë të çrregullt dhe provat nuk arsyetohen lidhur me faktin penal, ashtu si në procedimin penal të analizuar më sipër. Në tekstin e këtij dokumenti, nuk përmenden dispozitat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Akti më tepër i ngjan një dokumenti me konstatime se sa një kërkesë për gjykim, ku prokurori ka kryer hetime dhe ka arritur në disa konkluzione lidhur me figurën e veprës penale dhe arsyet përse kërkon që personat të gjykojnë për veprat e akuzuara. Akti nuk përmban as datën e përpilimit/dorëzimit, si një nga parashikimet e nenit 331 të K.Pr.Penale, por vetëm nënshkrimin e subjektit të rivlerësimit.

15.5.5 Në analizë të konstatimeve të mësipërme, në raport me konkluzionin e Komisionit, si dhe në mungesë të argumenteve konkrete të subjektit të rivlerësimit në ankim për këtë procedim penal, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se subjekti nuk ka arsyetuar dhe argumentuar veprimet hetimore, për të konkluduar në një vendim të qartë, të thelluar dhe të analizuar mbi bazën e akteve të administruara në dosjen hetimore, si dhe elementet konkrete të veprës penale, të cilat kanë çuar në bindjen e prokurorit se vepra penale është kryer nga të akuzuarit dhe, për pasojë, duhej që çështja të dërgohej për gjykim. Sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit paraqet mangësi në drejtim të qartësimit të pjesës arsyetuese të dokumentit “Kërkesë për gjykim”, duke shkelur kështu parashikimet e nenit 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016. Sa më sipër, konstatimet e Komisionit për këtë procedim penal, janë të drejta dhe të bazuara në ligj.

15.6 *Kallëzimi penal nr. {***}, datë 23.09.2015*, është një nga pesë dosjet e shortuara, ku objekt shqyrtimi është dokumenti ligjor “Vendim për mosfillimin e procedimit penal”, datë 20.10.2015. Kallëzimi penal është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, pas referimit të kryer nga komisariati i Policisë së Qarkut Gjirokastrë, ku është marrë njoftim se në Spitalin Civil të Gjirokastrës është paraqitur znj. F. Sh., me banim në qytetin e Sarandës. E pranishme ka qenë edhe nëna e saj, znj. L. Sh., në deklarin e së cilës ka shpjeguar se në datën 18.09.2015, ka debatuar me vajzën e saj F. Sh., debat nga i cili vajza është larguar. Pasi është kthyer, i ka treguar nënës së saj se ka marrë një ilaç në farmaci, të quajtur “xanax”, nga i cili vajza ka filluar të ketë turbullira dhe nëna e saj e ka dërguar në

spitalin e Gjirokastrës. E pyetur për faktin penal, nëna e vajzës ka shpjeguar se znj. F. Sh. vuan nga probleme të depresionit dhe ka momente që nuk e përballon me qetësi. Nga analiza në tërësi e akteve të materialit kallëzues, subjekti i rivlerësimit ka arritur në përfundimin se fakti nuk përbën vepër penale.

15.6.1 Kolegji vëren se lidhur me procedimin penal të cituar më sipër, Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit rezulton se nuk ka arsyetuar vendimin për mosfillimin e procedimit penal dhe baza ligjore për sa i përket vendimit të mosfillimit, rezulton se nuk është e identifikuar saktë, pasi ajo e duhura është neni 290, pika 1, shkronja “ç” e K.Pr.Penale.

Lidhur me këto konstatime, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime dhe paraqitur prova për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit. Subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime specifike lidhur me këtë procedim penal dhe as ka dorëzuar prova për të provuar të kundërtën e barrës së provës. Të vetmet shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit për kriterin e aftësive profesionale, janë ato të cilat janë cituar në paragrafët më sipër (15.4.2 dhe 15.5.2), për të cilat shprehet në përgjithësi, pa u ndalur në rrethana specifike të procedimeve që u përkasin dokumenteve të vlerësuara.

15.6.2 Në raportin e KLP-së, lidhur me përmbajtjen e aktit procedural “Vendim për mosfillimin e procedimit penal”, është konstatuar se në pjesën hyrëse pasqyrohen të dhënat mbi organin që ka nxjerrë aktin, emërtimin e aktit, llojin dhe datën e përpilimit, materialin kallëzues të referuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastrë. Pjesa përshkruese pasqyron faktin penal dhe rrethanat e ndodhjes së tij. Në vijim, subjekti i rivlerësimit tregon mënyrën se si organi procedues është vënë në dijeni të faktit penal, veprimet që ka kryer dhe aktet që ka administruar për të zbuluar të vërtetën. Në përfundim të kësaj pjese, parashtrohet vlerësimi për faktin penal të referuar, ku konkludon se mungojnë elementet e veprës penale, arsyet e së cilës nuk janë argumentuar në vendimmarrje nga ana e subjektit të rivlerësimit. Në konkluzion, subjekti i rivlerësimit ka vendosur se në materialin kallëzues, nuk rezulton të ketë elemente të veprës penale të “Shkaktimit të vetëvrasjes”, vepër kjo e parashikuar nga neni 99 i K.Penal. Siç evidentohet nga vendimi, subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë në analizë elementet e veprës penale.

15.6.3 Sa më sipër, lidhur me aktin “Vendim për mosfillimin e procedimit penal”, Kolegji vlerësoi se vendimi nuk është i arsyetuar. Në vendim, rezulton se baza ligjore e mosfillimit të procedimit penal është vendosur neni 290, pika 1, shkronja “a”¹² e K.Pr.Penale, dispozitë e cila lejon mosfillimin e procedimit penal kur personi ka vdekur. Ashtu siç Komisioni ka vlerësuar, baza ligjore në vendim nuk është e saktë, pasi ajo e duhura është neni 290, pika 1, shkronja “ç”¹³ e K.Pr.Penale, sipas së cilës rrethanat që lejojnë mosfillimin e procedimit penal, janë kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose kur del qartë që fakti nuk ekziston. Mundet që një rrethanë e tillë të ketë ardhur si pasojë e një gabimi material nga ana

¹² “Procedimi penal nuk mund të fillojë kur: a) Personi ka vdekur [...]”.

¹³ “Procedimi penal nuk mund të fillojë kur: [...] ç) Kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose kur del qartë që fakti nuk ekziston [...]”.

e subjektit të rivlerësimit, por një gjë e tillë nuk është pretenduar nga ai në prapësimet mbi rezultatet e hetimit dhe as në ankimin e paraqitur prej tij kundër vendimit të Komisionit, por referon se ka pasur mangësi në përpilimin e akteve procedurale për periudhën kohore 2014 e në vazhdim, që ka ardhur si pasojë e mosqëndrimit në punë, nga problemet familjare të shkaktuara si pasojë e divorcit, të ndodhur në vitin 2014.

15.6.4 Kolegji konstatoi se, përveç gabimit në bazën ligjore të dokumentit objekt vlerësimi, subjekti paraqet edhe mangësi lidhur me argumentimin ligjor të vendimmarrjes. Duke respektuar kufijtë e nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, sipas së cilës aftësitë profesionale vlerësohen pa gjykuar mbi themelin e çështjes dhe pa zëvendësuar interpretimin dhe logjikën e prokurorit, nga dokumenti vendim pushimi, Kolegji vëren mungesë të arsytimit ligjor lidhur me elementet e veprës penale të shkaktimit të vetëvrasjes, si elemente të domosdoshme të figurës konkrete të veprës penale, për të ardhur në konkluzionin që nuk ekzistojnë dhe, për pasojë, nuk ka as vepër penale. Subjekti i rivlerësimit nuk ka argumentuar kushtet, me të cilat rrethanat e kallëzimit penal përjashtojnë mundësinë e ekzistencës së veprës penale. Është evidente se në vendimin e pushimit të procedimit penal, citohen rrethanat në të cilat ka ndodhur ngjarja e referuar nga Policia e Gjirokastrës dhe në përfundim, subjekti i rivlerësimit arrin në konkluzionin se nuk kemi elemente të veprës penale. Në vendim nuk janë dhënë arsytet konkrete dhe as nuk janë analizuar provat e mbledhura që çuan në konkluzionin e mosekzistencës së këtyre elementeve për veprën penale të “Shkaktimit të vetëvrasjes”, parashikuar nga neni 99 i K.Penal. Arsyetimi i vendimit të mosfillimit të procedimit penal është i detyrueshëm, sipas parashikimit të nenit 291, pika 1¹⁴ e K.Pr.Penale dhe i domosdoshëm me qëllim parandalimin e mosfillimeve të kundërligjshme të procedimeve penale. Për këtë arsye, legjislacioni penal ka parashikuar edhe detyrimin e organit procedues për të bërë njoftimin e këtij vendimi ndaj personit të cilit i është bërë kallëzimi ose ankimi, si subjekt i interesuar në mënyrë që t’i garantohet ligjshmëria dhe të mund ta kundërshtojë atë brenda afatit të përcaktuar në K.Pr.Penale. Trupi gjykues i Kolegjit, lidhur me sa më sipër, arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka demonstruar mangësi në drejtim të aspektit të arsytimit ligjor, qartësisë dhe kuptueshmërisë së akteve të prokurorisë, ndaj kjo shkelje do të mbahet në konsideratë në kuptim të nenit 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, pasi vlerësohet se qartësia dhe kuptueshmëria e aktit të prokurorit është cenuar. Sa më sipër, konstatimet e Komisionit për këtë procedim penal, janë të drejta dhe të bazuara në ligj.

15.7 *Lidhur me procedimin penal nr. {***}, regjistruar në datën 03.12.2014*, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, për veprën penale “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”, të parashikuar nga neni 298 i K.Penal, objekt vlerësimi është dokumenti ligjor “Vendim për pushimin e procedimit penal nr. {***}”, hartuar nga subjekti i rivlerësimit.

15.7.1 Kolegji vëren se, me marrjen e materialit kallëzues nga individi D. T., subjekti i rivlerësimit ka kryer veprimet procedurale që kanë të bëjnë me administrimin e praktikës

¹⁴ Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit.

ligjore për kallëzimin në fjalë. Janë kërkuar të dhëna nga ana e personit nën hetim F. L. dhe, nga ana e policisë gjyqësore, është arrestuar në flagrancë ky person në datën 02.12.2014. Po në këtë datë, nga ana e subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenet 228, 229, 251, 258 dhe 259 të K.Pr.Penale, është kërkuar të vleftësohet i ligjshëm arrestimi në flagrancë dhe për të dyshuarin të caktohet masa e sigurimit personal “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, e parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale. Në datën 03.12.2014, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve” mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 298 dhe 22 të K. Penal, si dhe regjistrimin e individit F. V. si të dyshuar për kryerjen e kësaj vepre penale. Me vendimin e datës 31.12.2014, në cilësinë e prokurorit të çështjes [subjekti i rivlerësimit], në bazë të nenit 328, pika 1, shkronja “c” e Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. {***} për veprën penale “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”, të parashikuar nga neni 298 i K.Penal, ndaj personit F. L..

15.7.2 Lidhur me procedimin penal të cituar më sipër, Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se: “subjekti i rivlerësimit nuk ka argumentuar se përse duhet të vleftësohet arrestimi në flagrancë dhe përse duhet të caktohet masa e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”; vendimi i pushimit rezulton se është i paargumentuar pasi subjekti i rivlerësimit jo vetëm nuk ka arsyetuar shkaqet ligjore të pushimit të çështjes, por mbi të gjitha, nuk është shprehur për masën e sigurimit me karakter shtrëngues të personit nën hetim; subjekti i rivlerësimit rezulton se nuk ka bërë asnjë analizë të figurës së veprës penale dhe nuk ka dhënë arsyen se përse pushohet ky procedim penal; baza ligjore e identifikuar nga subjekti, rezulton se është e gabuar pasi në vendim, është vendosur si bazë ligjore e pushimit të procedimit penal neni 328, pika 1, shkronja “c” e Kodit të Procedurës Penale; vendimi i është njoftuar të dëmtuarit nga vepra penale, por jo të hetuarit. Rezulton se subjekti nuk ka kryer një hetim të plotë nga regjistrimi i procedimit penal, në ngarkim të autorit të dyshuar F. L., në datën 03.12.2014, deri në datën e vendimmarrjes, vendim pushimi, datë 31.12.2014, pasi nuk ka kryer asnjë veprim hetimor të mëtejshëm”.

Lidhur me këto konstatime, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit. Subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime specifike lidhur me këtë procedim penal dhe as ka dorëzuar prova për të provuar të kundërtën e barrës së provës, duke u qëndruar argumenteve të dhëna në prapësimet e rezultateve të hetimit për mangësitë e akteve procedurale të hartuara prej tij, të lidhura me situatën e tij të rënduar familjare.

15.7.3 Kolegji vëren se në raportin e KLP-së lidhur me vendimin për pushimin e procedimit penal, është evidentuar se dokumenti është i ndarë dhe i strukturuar në pjesë hyrëse disi përshkruese, dhe konkluduese për mënyrën e përfundimit të çështjes, por mungon pjesa përshkruese-argumentuese. Nga përmbajtja e aktit procedural vendim pushimi, konstatohet se nuk janë respektuar rregullat e drejtshkrimit. Rezulton se vendimi i është njoftuar të dëmtuarit nga vepra penale, por jo të hetuarit. Shkresa përcjellëse mban numër protokolli, por nuk mban datën përkatëse që është përpiluar. Referimi i policisë gjyqësore në prokurori, është bërë për veprën penale “Shtrëngimi me anë të kanosjes për dhënien e pasurisë”, parashikuar nga neni

109/b i K.Penal. KLP-ja gjithashtu ka konstatuar se vendimmarrja e prokurorit, subjektit të rivlerësimit, nuk është pasojë e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm pasi nga momenti që është regjistruar procedimi penal në ngarkim të autorit F. L., në datën 03.12.2014, deri në datën e pushimit të procedimit penal, datë 31.12.2014, subjekti i rivlerësimit nuk duket të ketë kryer veprime hetimore të mëtejshme që të kenë ndryshuar rrjedhën e hetimeve.

15.7.4 Kolegji vlerëson se nga rrethanat e cituara më sipër, si dhe nga fashikulli penal i administruar në dosjen e Komisionit, rezulton se në kërkesën për “Vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit”, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, nuk ka relatuar asnjë shkak ligjor se përse duhet të vleftësohet arrestimi në flagrancë apo përse duhet të caktohet një masë sigurimi me karakter shtrëngues, siç është ajo e “Detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Subjekti i rivlerësimit nuk ka renditur kriteret mbi të cilat duhet të caktohet masa e sigurimit që ka kërkuar për të akuzuarin, si dhe nuk i ka paraqitur gjykatës shkaqet dhe argumentet e përshtatshmërisë së kësaj mase me shkallën e nevojave të sigurimit që duhej marrë në rastin konkret, sipas nenit 229, pika 1 e K.Pr.Penale. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete, ku mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga K.Penal, të cilat subjekti i rivlerësimit nuk i ka marrë fare në analizë, por arrin në konkluzion menjëherë pas relatimit të rrethanave.

15.7.5 Trupi gjykues vlerëson se vendimi i pushimit të procedimit penal nr. {***}, rezulton se është i paargumentuar pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka arsyetuar shkaqet ligjore të pushimit të çështjes, si dhe nuk ka bërë asnjë analizë të figurës së veprës penale, duke e lidhur me arsyet e pushimit të procedimit penal. Në vendim, baza ligjore e identifikuar nga subjekti i rivlerësimit, duket se është e gabuar, pasi është vendosur neni 328, pika 1, shkronja “c”¹⁵ e K.Pr.Penale, ndërkohë që ligjvënësi ka parashikuar se kjo bazë ligjore shërben për pushimin e procedimit penal kur i dëmtuari nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij. Në këtë rast, baza ligjore e duhur e vendimit të pushimit të procedimit penal, duhet të ishte neni 328, pika 1, shkronja “b”¹⁶ e K.Pr.Penale. Gjithashtu, në fashikullin penal të administruar në dosjen e Komisionit, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime, pasi të vetmet akte që ka nënshkruar subjekti, në cilësinë e prokurorit, kanë të bëjnë me kthimin e sendeve të sekuestruara autorit të dyshuar. Nga analiza e rrethanave më sipër, si dhe nga mungesa e argumenteve në ankim, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka demonstruar mangësi në drejtim të aspektit të njohurive të ligjit, si dhe në drejtim të aspektit të arsytimit ligjor, qartësisë dhe kuptueshmërisë së akteve të prokurorisë, sipas parashikimeve të nenit 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016. Sa më sipër, konstatimet e Komisionit për këtë procedim penal, janë të drejta dhe të bazuara në ligj.

¹⁵ “[...] prokurori vendos pushimin e akuzës kur: c) viktima nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij [...]”.

¹⁶ “[...] prokurori vendos pushimin e akuzës kur: b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale [...]”.

15.8 Lidhur me procedimin penal nr. {*}**, regjistruar për veprën penale të “Organizimit të lotarive të palejuara”, parashikuar nga neni 197 i K.Penal, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, objekt vlerësimi është dokumenti ligjor “Vendim për pushimin e procedimit penal nr. {***}”, hartuar nga subjekti i rivlerësimit. Subjekti, më datë 08.06.2015, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal me nr. {***} dhe në datën 10.06.2015, ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore. Me vendimin e datës 14.11.2015, në bazë të nenit 328, pika 1, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e hetimeve në ngarkim të individit A. R., në lidhje me procedimin penal nr. {***}, për veprën penale të “Organizimit të lotarive të palejuara”, parashikuar nga neni 197 i K.Penal, për arsye se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

15.8.1 Kolegji vëren se mbi bazën e materialit kallëzues nr. {***} prot., datë 08.06.2015, të Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në datën 08.06.2015, ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, për veprën penale të “Organizimit të lotarive të palejuara”, parashikuar nga neni 197 i K.Penal. Nga hetimet e zhvilluara në lidhje me këtë procedim penal, ka rezultuar se shërbimet e Policisë Gjyqësore në Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë, në datën 06.06.2015, pas dyshimeve dhe të dhënave se ishin krijuar kushtet për organizimin e lojërave të fatit, kanë ushtruar kontroll në ambientet e një lokali të ndodhur në {***}, Gjirokastrë, ku ushtronte aktivitetin “bar-kafe” individi A. R.. Në lokalitë ku ushtrohej aktiviteti dhe në një pjesë të ambienteve të brendshme të tij, ishin vendosur dy automate të përmasave të vogla për lojëra fati dhe njësi kompjuterike, së bashku me monitorët përkatës. Sipas veprimeve hetimore të kryera për këtë procedim penal, pajisjet nuk ishin të lidhura me energji elektrike, pra nuk kishin kabull elektriciteti dhe ishin në pozicion magazinimi. Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit të këtij procedimi penal, rezulton se individi i sipërcituar nuk është pajisur me leje për ushtrimin e aktivitetit “lojëra fati” dhe nuk rezulton të jetë i punësuar nga shoqëritë e lojërave të fatit, madje nuk figuron as të jetë i regjistruar për aktivitet privat në Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, sipas informacionit të kësaj të fundit. Vetë A. R. ka deklaruar gjatë hetimit se këto pajisje i mbante në magazinë për t’i përdorur si pjesë këmbimi elektronike, pasi ato nuk kishin asnjë vlerë tjetër. Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, me cilësinë e prokurorit të çështjes, bazuar në nenin 328, pika 1, shkronja “b” e K.Pr.Penale, ka disponuar me vendim pushimi për procedimin penal, me arsyetimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

15.8.2 Kolegji vëren se Komisioni gjatë hetimit administrativ, lidhur me këtë procedim penal, ka konstatuar se nga përmbajtja e dokumentit “Vendim për pushimin e procedimit penal”, subjekti i rivlerësimit rezulton se nuk ka arsyetuar në mënyrë të plotë dhe të qartë shkaqet ligjore të pushimit të çështjes; subjekti i rivlerësimit rezulton se nuk ka bërë analizë të figurës së veprës penale. Lidhur me këto konstatime, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektivitetit të rivlerësimit për të dhënë shpjegime dhe paraqitur prova për të provuar të kundërtën e këtyre konstatimeve. Sërish subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime specifike lidhur me këtë procedim penal dhe as ka dorëzuar prova për të provuar të kundërtën e barrës së provës, duke u qëndruar argumenteve të dhëna në prapësimet e rezultateve të hetimit për mangësitë e akteve procedurale të hartuara prej tij, të lidhura me situatën familjare që ka kaluar në vitin 2014.

15.8.3 Kolegji konstaton se në raportin e KLP-së lidhur me vendimin për pushimin e procedimit penal, është evidentuar se përgjithësisht vendimi është i strukturuar si aktet e kësaj natyre, i ndarë në pjesën hyrëse, por mungon pjesa arsyetuese, mbi të cilën është mbështetur vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, KLP-ja ka konstatuar se nuk janë arsyetuar bindshëm shkaqet ligjore të pushimit të çështjes, si dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë analizë të figurës së veprës penale.

15.8.4 Në përfundim të analizës së rrethanave të trajtuar më sipër, Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit në këtë procedim penal, në mënyrë të përsëritur, si edhe në rastet më sipër, sjell një format të paarsyetuar të vendimmarrjes lidhur me pushimin e procedimit penal. Në vendimmarrjen e tij, subjekti i rivlerësimit pasqyron veprimet hetimore që ka kryer organi procedues për hetimin e çështjes, si dhe rezultatet e dala nga këto veprime hetimore, por nuk i analizon në funksion të analizës së figurës së veprës penale, për të argumentuar përse jemi përpara një fakti që nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Gjithashtu, nga materialet e fashikullit penal të administruar në dosjen e Komisionit, vërehet se duheshin kryer edhe veprime të tjera hetimore, siç mund të jetë kryerja e ekspertimit teknik të pajisjeve automate/njësi kompjuterike për të vlerësuar gjendjen e tyre teknike, për të arritur në vendimmarrjen e pushimit të çështjes për arsye se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Vërehet që në fashikullin penal, nuk është kryer një akt ekspertimi i konstatimit të gjendjes teknike të pajisjeve të gjetura në aktivitetin privat të individit A. R., për t'u qartësuar nëse pajisjet ishin në gjendje pune dhe në çdo moment mund t'i nënshtroheshin aktivitetit të lojërave të fatit, apo ishin jashtë kushteve teknike dhe gjendeshin thjesht të magazinuara në ambientet e lokalit. Në këto kushte, ku kemi praninë e mungesës së arsyetimit të vendimit të pushimit, Kolegji çmon se këto veprime bëjnë të duket si shmangie e subjektit të rivlerësimit nga ekspozimi i moskryerjes së veprimeve hetimore. Në përfundim të sa më sipër, Kolegji arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka demonstruar mangësi në drejtim të marrjes së veprimeve hetimore, të arsyetimit ligjor dhe argumentimit logjik, qartësisë dhe kuptueshmërisë së akteve të prokurorisë sipas parashikimeve të nenit 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016. Sa më sipër, konstatimet e Komisionit për këtë procedim penal, janë të drejta dhe të bazuara në ligj.

15.9 *Lidhur me procedimin penal nr. {***}, regjistruar në datën 21.04.2012*, për veprën penale të “Vjedhjes”, në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 134, paragrafi 2 i K.Penal, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, objekt shortimi dhe vlerësimi është dokumenti ligjor “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. {***}, viti 2012” (data mungon), përgatitur nga subjekti i rivlerësimi. Duke u bazuar në materialin kallëzues të referuar nga Komisariati i Policisë Sarandë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, nga aktet e të cilit rezulton se individi Y. K. ka referuar faktin se në magazinën në pronësi të tij, e ndodhur në fshatin {***} të Sarandës, ishin vjedhur dy skarat e hekurit që vetë kallëzuesi i kishte vendosur në dritaret e magazinës. Kallëzuesi sapo e ka konstatuar, ka ndërmarrë takim me një individ të njohur si A. R., me të cilin ka replikuar verbalisht pasi kishte dyshime se ky individ ishte në dijeni për ngjarjen. Vetë kallëzuesi ka ndërmarrë disa hapa për zbulimin e ngjarjes, duke shkuar në magazinën e z. K. D. që mblidhte materiale hekuri, ku dhe ka konstatuar se skarat e hekurit gjendeshin aty. Ky

i fundit ka referuar faktin se skarat e hekurit i kishin dërguar në magazinën e tij Xh. I. dhe M. P., me makinën e drejtuar prej individi A. R. dhe ia kanë shitur përkundrejt vlerës 3500 euro, para të cilat ua ka dhënë dy të pandehurve, Xh. I. dhe M. P.. I njëjti fakt është konfirmuar edhe nga A. R., i cili ka shtuar se nuk kishte dijeni për veprimet e kundërligjshme të të pandehurve.

15.9.1 Kolegji vëren se subjekti rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, në datën 22.04.2012, ka paraqitur njëkohësisht në gjykatë kërkesën për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë ndaj të pandehurve Xh. I., M. P. dhe A. R., si dhe caktimin ndaj tyre të masës së sigurimit personal “Detyrimin për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale. Me vendimin, datë 25.06.2012, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 34 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur “Për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës” dhe u ka njoftuar akuzën vetëm të pandehurve Xh. I., M. P., të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vjedhje në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 134, paragrafi 2 i Kodit Penal. Në datën 20.07.2012, subjekti i rivlerësimit është shprehur për pushimin e hetimeve në ngarkim të të hetuarit A. R., bazuar në nenin 378/1, shkronja “dh” e K.Pr.Penale, bazë ligjore e referuar gabim nga subjekti i rivlerësimit, pasi neni 378/1 nuk ekziston, në vend që të bazohej në nenin 328, pika 1, shkronja “dh”¹⁷ e K.Pr.Penale, me argumentin se pushimi i hetimeve ka ardhur si pasojë se del që i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai.

15.9.2 Kolegji vëren se nga aktet e fashikullit penal, rezulton se subjekti i rivlerësimit në aktin “Diskutime përfundimtare të procedimit penal nr. {***}”, ka kërkuar: deklarimin fajtor për të pandehurin Xh. I. për veprën penale të “vjedhjes”, parashikuar nga neni 134, paragrafi 1 i K.Penal, si dhe tërheqjen e akuzës në ngarkim të të pandehurit M. P., duke kërkuar edhe pushimin e gjykimit ndaj tij dhe, për këtë kërkesë, KLP-ja ka evidentuar se subjekti i rivlerësimit ka vënë si bazë ligjore nenin 378 të K.Pr.Penale që lidhet me zhvillimin e diskutimit përfundimtar, por pa argumentuar shkaqet e kërkesave që janë krejtësisht të ndryshme me ato të paraqitura në aktin “Kërkesë për gjykim”, pjesë e të cilit ishte edhe M. P., për të cilin subjekti ka kërkuar tërheqjen e akuzës. Pasi gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, më datë 16.05.2013, ka vendosur deklarimin fajtor të individit Xh. I. dhe kalimin e akteve Prokurorisë Gjirokastër për të pandehurin M. P., subjekti i rivlerësimit, më datë 30.12.2013, ka vendosur pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit M. P.. Vërehet se argumentet që subjekti përdor, janë të njëjtat që ka bërë në diskutimin përfundimtar më sipër, madje edhe baza ligjore është e pasaktë, pasi është referuar neni 378 në vend të nenit 328 të K.Pr.Penale.

15.9.3 Lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2012, Komisioni gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se: “Është e paqartë se cila ka qenë arsyeja që subjekti ka pushuar çështjen vetëm për të pandehurin A. R.; vendimi i pushimit rezulton se është i paarsyetuar; subjekti

¹⁷ “Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur: [...] dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai [...]”.

rezulton se nuk ka kryer një hetim të plotë; baza ligjore rezulton se është e pasaktë; baza ligjore e vendosur nga subjekti lidhet me “zhvillimin e diskutimit përfundimtar” që nuk ka asnjë koherencë ligjore apo logjike me “pushimin e hetimeve”; subjekti i rivlerësimit rezulton se për arsye “extra procedurale” ka vendosur pushimin e procedimit penal; subjekti rezulton se nuk ka argumentuar vendimin për pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit M. P.; fakti penal parashtrohet nga ana e prokurorit në mënyrë të përmbledhur, por jo në kuadratin e kërkesave formale që parashikon neni 331 i K.Pr.Penale; nuk përmenden në arsyetim normat e Kodit Penal, por përmenden në arsyetim normat e Kodit të Procedurës Penale”. Lidhur me këto konstatime, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime dhe paraqitur prova për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimeve. Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti prova, si dhe në prapësimet për rezultatet e hetimit, nuk gjenden kundërshtime lidhur me gjetjet e Komisionit, duke mos provuar të kundërtën e barrës së provës.

15.9.4 Kolegji konstaton se KLP-ja, lidhur me dokumentin “Kërkesë për gjykim”, ka evidentuar se ky dokument në tërësinë e tij, është i pastrukturuar dhe i paargumentuar, me mungesë të theksuar koherence ligjore dhe logjike. Pjesës arsyetuese i mungon dhe fakti penal përshkruhet me një narrativë që lë për të dëshiruar qoftë nga pikëpamja formale, qoftë nga ana gramatikore. Akti nuk mban datën e përpilimit, por nënshkrimin e subjektit të rivlerësimit. Në arsyetim nuk përmenden normat e Kodit Penal, por vetëm ato të Kodit të Procedurës Penale.

15.9.5 Në përfundim të analizës së rrethanave të trajtuara më sipër, Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit në këtë procedim penal, gjendet në situatën e përsëritur ashtu si edhe në procedimet e tjera penale objekt shqyrtimi, ku aktet procedurale të hartuara prej tij, janë pa arsyetim, të paargumentuara, në të cilat nga parashtrimi i fakteve, arrihet menjëherë në konkluzion, pa bërë analizë se si arriti në përfundimet konkrete. Rezultoi se në aktin e vleftësimit të ligjshëm të arrestit në flagrancë ndaj të pandehurve, si dhe kërkimin e caktimit të masës së sigurimit, nuk argumentohen shkaqet e nevojës për sigurim për tre të pandehurit. Gjithashtu, në vendimin e datës 20.07.2012, subjekti i rivlerësimit është shprehur për pushimin e hetimeve në ngarkim të të hetuarit A. R., bazuar në nenin 378/1, shkronja “dh” e K.Pr.Penale, me argumentin se “nuk ka prova”, sërish një vendim i paarsyetuar dhe i pambështetur në një hetim të plotë, pasi nuk janë pyetur persona të tjerë, përveç atyre ndaj të cilëve zhvillohen hetime, si dhe me bazë ligjore të pasaktë, pasi nuk ekziston neni 378/1 në K.Pr.Penale dhe baza ligjore duhet të ishte neni 328/1, shkronja “dh” e K.Pr.Penale. Edhe dokumenti objekt vlerësimi, “Kërkesë për gjykim”, ndodhet në kushtet ku fakti penal nuk është parashtruar sipas kërkesave formale të nenit 331 të K.Pr.Penale (para ndryshimit me ligjin nr. 35/2017), ku fakti penal duhet të parashtrohet duke treguar nenet përkatëse të Kodit Penal dhe dokumenti është i paargumentuar dhe i paarsyetuar për të arritur në konkluzionin e dhënë, duke mos i kushtuar vëmendje dhe analizë të mjaftueshme. Si rrjedhojë e sa më sipër, Kolegji arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka demonstruar mangësi në drejtim të aspektit të arsyetimit ligjor, qartësisë dhe kuptueshmërisë së akteve të prokurorisë sipas nenit 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016. Sa më sipër, konstatimet e Komisionit për këtë procedim penal, janë të drejta dhe të bazuara në ligj.

15.10 Lidhur me procedimin penal numër {*}, regjistruar në datën 16.02.2014**, për veprat penale të “Prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike” dhe “Drejtimin të mjetit në mënyrë të parregullt”, të parashikuara nga nenet 283, paragrafi 1 dhe 291 të K.Penal, objekt vlerësimi është dokumenti ligjor “Për gjykimin e procedimit penal nr. {***}, viti 2014”, (pa datë), përgatitur nga subjekti i rivlerësimit. Duke u bazuar në materialin kallëzues të Komisarariatit të Policisë Gjirokastër, nga aktet e të cilit rezulton se nga kontrolli i ushtruar nga shërbimet e policisë gjyqësore në një automjet në fshatin {***}, Gjirokastër, kanë gjetur një sasi prej 5,8 gramësh lënde të dyshuar narkotike. Në këtë automjet, kanë qenë personat C. R. (i mitur) në drejtim të mjetit dhe Xh. Gj. pasagjer, të cilët, pas kontrollit, janë shoqëruar në mjediset e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Gjirokastër. Referuar aktit të ekspertimit bio-kimik nr. {***}, datë 31.03.2014, ka rezultuar se materiali bimor i sekuestruar në cilësinë e provës materiale, është *cannabis sativa*, produkt herbal i bimës *cannabis sativa L.* Nga akti i ekspertimit toksikologjiko-ligjor i Institutit të Mjekësisë Ligjore nr. {***}, datë 11.03.2014, ka rezultuar se C. R. është përdorues i lëndëve narkotike. Gjithashtu, referuar përgjigjes¹⁸ së Drejtorisë Rajonale të Transportit Rrugor Gjirokastër, rezulton se ky individ nuk është pajisur me leje drejtimi automjeti.

15.10.1 Kolegji vëren se nga materiali referues i policisë gjyqësore, subjekti i rivlerësimit, më datë 17.02.2014, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal dhe emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale. Procedimi penal është regjistruar për veprat penale të “Prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike” dhe “Drejtimin të mjetit në mënyrë të parregullt”, të parashikuara nga neni 283, paragrafi 1 dhe 291 i K.Penal, në ngarkim të individit C. R.. Më datë 05.04.2014, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 34 të K.Pr.Penale, ka marrë vendimin për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës për të njëjtin person. Në vendimin për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës, ka rezultuar se të pandehurit i është atribuar e njëjta akuzë me të cilën është regjistruar procedimi penal. Bazuar në nenin 331 të K.Pr.Penale, subjekti i rivlerësimit, me “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. {***}”, ka paraqitur për gjykim procedimin penal në ngarkim të të pandehurit C. R., përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

15.10.2 Komisioni, lidhur me dokumentin e hartuar nga subjekti i rivlerësimit, “Kërkesë për gjykim”, gjatë hetimit administrativ ka konstatuar se, në përputhje me nenin 331 të K.Pr.Penale, kërkesa nuk rezulton t’i jetë njoftuar të pandehurit, pasi në të nuk evidentohet nënshkrimi i të pandehurit. Lidhur me këtë gjetje, e njëjtë me atë të konstatuar nga KLP-ja në raportin profesional të hartuar për subjektin i rivlerësimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektivit të rivlerësimit për të dhënë shpjegime dhe paraqitur prova për të provuar të kundërtën në lidhje me këtë konstatim. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, nuk i është përgjigjur barrës së provës lidhur me këto konstatime dhe as ka paraqitur dokumentacion për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe gjetjeve të Komisionit.

¹⁸ Shkresa me nr. {***}, datë 08.04.2014.

15.10.3 Në përfundim të rrethanave të cituara më sipër, Kolegjit i rezultoi se dokumenti objekt vlerësimi, “Kërkesë për gjykim”, hartuar nga subjekti i rivlerësimit, rezulton të jetë i strukturuar, i qartë, si dhe fakti penal parashtrohet ashtu siç ka rezultuar gjatë zhvillimit të hetimeve. Në vijim parashtrohet vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri, konkludimi për provueshmërinë e veprës penale dhe autorit, si dhe konkluzioni i subjektit të rivlerësimit për konsumimin e veprës penale nga i pandehuri. Dokumenti, ashtu si edhe në disa procedime më sipër, nuk mban datën e përpilimit nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, kërkesa për gjykim nuk rezulton t’i jetë njoftuar të pandehurit, në përputhje me nenin 331 të K.Pr.Penale, pasi në të nuk evidentohet nënshkrimi i të pandehurit, mangësi procedurale kjo, e cila mund t’i mohojë të pandehurit aksesin në organet e drejtësisë, si dhe për të realizuar mbrojtjen e interesave të tij të ligjshëm në hapat e mëtejshëm proceduralë. Procedimi penal është një veprimtari me raporte të caktuara midis personave që marrin pjesë në të dhe harmonizimi i kësaj veprimtarie bëhet i mundur vetëm nëpërmjet përcaktimit të rregullave të komunikimit midis tyre dhe njoftimit të akteve që u bëjnë të ditur personave të interesuar për veprimet procedurale. Një mangësi e tillë u mohon personave pjesëmarrës në një procedim penal, të drejtën për t’u ankuar në institucionet më të larta gjyqësore për të vendosur të drejtën e pretenduar apo të shkelur, duke ndaluar në këtë mënyrë edhe kontrollin e ligjshmërisë së akteve të prokurorisë. Sa më sipër, Kolegji arrin në përfundimin për këtë procedim penal, se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e shkeljes së nenit 74, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, pasi njoftimi i vendimmarrjes së prokurorit, si veprimtari e rëndësishme e procedurave hetimore, duket se është cenuar. Sa më sipër, konstatimet e Komisionit për këtë procedim penal, janë të drejta dhe të bazuara në ligj.

15.11 Komisioni ka hetuar gjithashtu për procedimin penal nr. {*} dhe, për këtë arsye, i ka kërkuar informacion¹⁹ Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, ku nga kjo e fundit ka kthyer përgjigje²⁰, duke vënë në dispozicion dosjen e procedimit penal dhe gjykimin në ngarkim të individit G. S.. Ky procedim penal ka nisur si rrjedhojë e kallëzimit të kryer nga znj. E. G., e cila e akuzon G. S. për përndjekje, pasi ky individ disa herë i ka dërguar mesazhe kërcënuese, si dhe e ka ndjekur me makinë dhe ka dashur ta marrë me forcë kallëzuesen. Nga këto referime të kallëzueses, subjekti i rivlerësimit, si prokuror i çështjes, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal më datë 27.10.2015, për veprën penale të “Përndjekjes”, parashikuar nga neni 121/a i K.Penal, në ngarkim të të pandehurit G. S..**

15.11.1 Kolegji vëren se nga shqyrtimi i dokumentacionit që gjendet në fashikullin penal të administruar në dosjen e Komisionit, rezulton se në datën 07.12.2015, subjekti ka vendosur dërgimin e çështjes për gjykim, të procedimit penal nr. {***}, në ngarkim të të pandehurit G. S., për veprën penale “Përndjekje”, parashikuar nga neni 121/a, paragrafi 1 i Kodit Penal. Subjekti ka dërguar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, kërkesën për gjykim të këtij procedimi penal. Komisioni ka marrë në shqyrtim dokumentin “Kërkesë për gjykim”, “Kërkesën për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit”, sipas së

¹⁹ Shkresa nr. {***} prot., datë 24.02.2020.

²⁰ Shkresën nr. {***} prot., datë 10.03.2020.

cilës subjekti i rivlerësimit ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”. Nga analizimi i këtyre kërkesave, Komisionit i ka rezultuar se në dokumentin “Kërkesë për gjykim”, subjekti i rivlerësimit nuk analizon faktin penal dhe figurën e veprës penale të “Përndjekjes”, të parashikuar nga neni 121/a, paragrafi i parë i K.Penal, si dhe në kërkesën për vleftësimin e arrestit me burg. Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka argumentuar shkaqet dhe arsyet ligjore të vleftësimit të ligjshëm të arrestit në flagrancë, nuk ka arsyetuar nevojat e sigurisë në rastin konkret për caktimin ndaj të pandehurit të masës së sigurimit “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. Lidhur me këto konstatime, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime dhe paraqitur prova për të provuar të kundërtën e tyre, për të cilat subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur prova, por as argumente konkrete lidhur me këtë procedim penal.

15.11.2 Si rrjedhojë e sa më sipër, Kolegji vlerësoi se subjekti i rivlerësimit në dokumentin kërkesë për gjykim, nuk e ka strukturuar dokumentin dhe gjithashtu, si në rastet e vlerësuara më sipër, është i paargumentuar. Subjekti ndodhet në kushtet ku nuk analizon faktin penal dhe figurën e veprës penale të “Përndjekjes” të parashikuar nga neni 121/a, paragrafi 1 i K.Penal. Gjithashtu, në këtë akt procedural, rezulton se subjekti nuk përmend në arsyetim normat e Kodit Penal dhe normat e Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu, Komisioni, me të drejtë, ka konstatuar se nuk janë argumentuar shkaqet dhe arsyet ligjore të vleftësimit të ligjshëm të arrestit në flagrancë, nuk janë arsyetuar nevojat e sigurisë në rastin konkret për caktimin ndaj të pandehurit të masës së sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, situata këto të përsëritura edhe në procedimet e tjera penale objekt vlerësimi të subjektit të rivlerësimit.

15.11.3 Kolegji vëren se në legjislacionin penal, masat e sigurimit caktohen nga gjyqtari mbi kërkesën e prokurorit, së cilës i bashkohen aktet, të dhënat, si dhe argumentet që tregojnë se ekzistojnë kushtet dhe plotësohen kriteret për caktimin e masës së sigurimit. Në dokumentin “Kërkesë për gjykim”, subjekti i rivlerësimit nuk ka argumentuar përshtatshmërinë e masës së sigurimit me shkallën e nevojës për sigurim të të pandehurit, konkretisht sa e madhe ishte nevoja për sigurim që lidhet kryesisht me shkallën e rrezikshmërisë së të akuzuarit dhe personalitetin e tij, në mënyrë që të përputhet me kërkesën e arrestit me burg. Po ashtu, nuk janë argumentuar rrethana konkrete që lehtësojnë apo rëndojnë përgjegjësinë e autorit të veprës penale, si përsëritja apo vazhdimësia, si rrethana që ndikojnë në kërkimin e masës së sigurimit. Gjithashtu, nuk janë argumentuar kriteret e nenit 230 të K.Pr.Penale, përse është zgjedhur masa e sigurimit “Arrest me burg” dhe çdo masë tjetër sigurimi është e papërshtatshme, që lidhet me rrezikshmërinë e veçantë të veprës penale. Si rrjedhojë e sa më sipër, Kolegji arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e shkeljes së nenit 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, pasi mungesa e arsyetimit dhe argumentimit të kërkesave dhe vendimmarrjeve të subjektit të rivlerësimit, çon në mangësi të aftësive të tij profesionale. Sa më sipër, konstatimet e Komisionit për këtë procedim penal, janë të drejta dhe të bazuara në ligj.

16. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankimin e paraqitur prej tij, se nuk ka marrë pjesë në aktivitetet trajnuese në kuadër të programit të trajnimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, gjatë periudhës 3-vjeçare të rivlerësimit, si dhe jashtë kësaj periudhe, duke shpjeguar se mungesa nga ana e tij, ka ardhur për shkak të ngarkesës së madhe në punë, gjë që evidentohet dhe nga raporti i grupit të punës, ku ngarkesa vjetore me dosje në hetim e gjykim, ka qenë e lartë.

16.1 Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, Kolegji vëren se në raportin e KLP-së e më pas edhe në vendimin e Komisionit, është konstatuar se subjekti nuk ka pjesëmarrje në aktivitete trajnuese. Në kuadër të programit të trajnimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe jashtë periudhës së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar se nuk ka pjesëmarrje të tilla. Pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni lidhur me mospjesëmarrjen e tij në trajnime, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se mungesa në këto trajnime ka ardhur për shkak të ngarkesës së madhe në punë, ku ngarkesa vjetore me dosje në hetim e gjykim ka qenë e lartë, duke mos përfshirë materialet kallëzuese, të cilat arrinin në rreth 120 materiale kallëzuese në vit.

16.2 Në vlerësim të situatës më sipër, Kolegji vlerëson se rëndësia e trajnimit të vazhdueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët qëndron në zbatimin efektiv të ligjit. Programi i trajnimit të vazhdueshëm zhvillohet në përmbushje të nevojave dhe pritjeve për një sistem gjyqësor profesional, etik, të paanshëm dhe të pavarur. Faktorët që përcaktojnë nevojën për trajnime të vazhdueshme kanë për qëllim përditësimin me infrastrukturën ligjore, nevojën për unifikim të praktikës gjyqësore, si dhe reformat në strukturën organizative të gjykatave dhe prokurorive. Në nenin 41, me titull “Ngritja profesionale”, të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i shfuqizuar me ligjin nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se prokurorët kanë të drejtë dhe detyrim të marrin pjesë në trajnime periodike për ngritjen e nivelit të tyre profesional. Më datë 18.07.2010, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë urdhrin nr. 107, “Mbi procesin e trajnimit të prokurorëve”, me synimin për të siguruar rritjen e vazhdueshme të profesionalizmit të prokurorëve, për të garantuar zbatimin e ligjit nga të gjithë prokurorët sipas të njëjtave standarde, dhe për të rritur eficiencën e drejtimit unik dhe të centralizuar të prokurorisë. Sipas këtyre akteve, ngarkesa e magjistratit nuk parashikohet si shkak që mund ta përjashtojë atë nga ndjekja e trajnimeve vazhduese, apo të përdoret si justifikim për mosmarrjen pjesë në trajnime vazhduese të Shkollës së Magjistraturës.

16.3 Një nga qëllimet e vlerësimit etik dhe profesional të magjistratit është të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme etikën dhe aftësitë profesionale dhe nga kjo rrjedh se nevoja për trajnim vazhdues bëhet për qëllime edhe të vlerësimit etik e profesional të magjistratit. Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e mospërmbushjes së detyrimit për trajnimin e vazhdueshëm, me qëllim zbatimin efektiv të ligjit. Sa më sipër, shkak i ankimit i ngritur nga subjekti i rivlerësimit, se mungesa e trajnimeve nga ana e tij, ka ardhur për shkak të ngarkesës së madhe në punë, nuk gjendet i bazuar në ligj.

17. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin e paraqitur prej tij, pretendon se vërtet me urdhrin nr. {***}, datë 16.02.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm është dhënë ndaj tij masa disiplinore “vërejtje”, në lidhje me një akt procedural “Zgjatje e afatit të hetimit” të një procedimi penal, por kjo mund t’i ndodhë çdo prokurori për shkak të ngarkesës në punë.

17.1 Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, si dhe i burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme, Komisionit i ka rezultuar se Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë vendimin me nr. {***}, datë 15.12.2011, “Për fillimin e hetimit disiplinor” për prokurorin Spartak Çoçoli. Kjo vendimmarrje është bazuar në informacionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjrokastër dhe në rezultatet e kontrollit nga Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore. Me urdhrin nr. {***}, datë 16.02.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin e rivlerësimit, është dhënë masa disiplinore “vërejtje”. Komisioni e ka përfshirë këtë informacion në rezultatet e hetimit për subjektin e rivlerësimit, si dhe në vendimin e arsyetuar të subjektit Çoçoli, ku me sa duket, një vendimmarrjeje të tillë, të nxjerrë nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, i është dhënë peshë nga Komisioni në drejtim të kategorizimit të kësaj mase disiplinore në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

17.2 Kolegji vëren se subjektin e rivlerësimit i është filluar procedimi disiplinor bazuar në nenin 28 të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i shfuqizuar me ligjin nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Në përfundim të këtij procedimi disiplinor, subjektin e rivlerësimit i është dhënë masa disiplinore “vërejtje”, e parashikuar nga neni 33, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 8737/2001, duke zbatuar procedurat që i përkasin procedimit disiplinor sipas këtij ligji. Sipas nenit 33, pika 4, shkronja “a”²¹ e këtij ligji, kjo masë disiplinore fshihet nga dosja kur kanë kaluar tre muaj nga dita që është dhënë. Në nenin 42, pika 1²² e ligjit nr. 84/2016, citohet se burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve, parashikohen në ligjin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në ligjin nr. 96/2016, burimet e vlerësimit parashikohen në nenin 77, ku ndër të tjera, në shkronjën “ë” të këtij neni, parashikohet se si burim vlerësimi, shërbejnë edhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore ndaj magistratit që janë dhënë gjatë periudhës së vlerësimit, në mënyrë të pavarur, nëse masa disiplinore është shuar ose jo. Lidhur me këtë situatë faktike dhe ligjore, Kolegji vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, për shkeljen e kryer, të rezultuar nga hetimi disiplinor i kryer ndaj tij, ka marrë masë disiplinore për aftësi të cunguara hetimore dhe organizative. Për më tepër, kjo masë disiplinore e subjektin e rivlerësimit tregon qartë për metodë të njëjtë pune nga ana e tij, e cila gjendet e përsëritur dhe e shtrirë në kohë, gjatë karrierës së tij profesionale, çka krijon bindjen e trupit gjykues se nuk ka ndodhur si rrjedhojë e ngarkesës së lartë

²¹ “Masat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni fshihen nga dosja kur kanë kaluar: a) tre muaj nga data që është dhënë masa sipas shkronjës “a””.

²² Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët vlerësohen bazuar në burimet e parashikuara në legjisllacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve. Prokurori i Përgjithshëm vlerësohet nëse ka përmbushur detyrat e parashikuara në nenin 8 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për një periudhë 3-vjeçare nga fillimi i mandatit.

në punë, rrethana këto të cilat përforcojnë konkluzionin e arritur nga Kolegji për cenimin e besimit të publikut nga ana e subjektit të rivlerësimit të figura e prokurorit.

18. Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet ankimit të paraqitur prej tij, pretendon se për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2016, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, për njohuritë ligjore, arsyetimet ligjore, aftësitë organizative, aftësisë për të përballuar ngarkesën në punë, për të cilat është vlerësuar “mjaftueshëm” në disa raste dhe “mirë” në disa raste të tjera, nuk është ushtruar asnjëherë kontroll nga Prokuroria e Përgjithshme, duke mos ditur se si kjo prokurori ka arritur në këto konkluzione. Subjekti i rivlerësimit shpjegon se i ka kërkuar Komisionit t’i vihen në dispozicion këto raporte.

18.1 Kolegji vëren se pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun ka të dhëna për vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit, vlerësim i kryer nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 42 të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i shfuqizuar, si dhe urdhrin nr. 221, datë 19.11.2012, “Për miratimin e rregullores për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”, dhe konkretisht janë administruar:

- a. vendim “Për vlerësimin e punës së prokurorit”, viti 2013, në nivel “**mirë**”;
- b. vendim “Për vlerësimin e punës së prokurorit”, viti 2014, në nivel “**mjaftueshëm**”;
- c. vendim “Për vlerësimin e punës së prokurorit”, viti 2015, në nivel “**mirë**”;
- ç. vendim “Për vlerësimin e punës së prokurorit”, viti 2016, në nivel “**mjaftueshëm**”.

18.2 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se Komisioni, pasi ka njoftuar subjektin e rivlerësimit Spartak Çoçoli në datën 02.06.2020, nëpërmjet postës elektronike, për përfundimin e hetimit kryesisht dhe kalimin e barrës së provës, i ka bërë me dije të drejtat në bazë të ligjit për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, lidhur me rezultatet e hetimit. Gjithashtu, subjektit të rivlerësimit iu mundësua aksesimi në dokumentacionin e çështjes, për të cilin subjekti ka plotësuar deklaratën e datës 11.06.2020, që ky dokumentacion i është vënë në dispozicion nga Komisioni. Pjesë e këtij dokumentacioni është edhe raporti i KLP-së me nr. {***} prot., datë 26.12.2019, në të cilin janë evidentuar nivelet e vlerësimit për vitet e cituara më sipër për subjektin e rivlerësimit nga Prokuroria e Përgjithshme. Në nenin 42, pika 1 e ligjit nr. 8737/2001, parashikohet vlerësimi i punës, sipas të cilit citohet: *Për vlerësimin e aftësive profesionale të prokurorëve, Drejtoria e Personelit dhe Inspektimit kryen detyrimisht inspektimin e planifikuar jo më pak se një herë në dy vjet.* Pra, një parashikim i tillë i ligjit të kohës mundësonte detyrimisht vlerësimin e punës jo më pak se një herë në dy vite. Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të sjellë dokumentacion justifikues, për të provuar të kundërtën e mospërputhjes që ka rezultuar në hetimet e Komisionit. Meqenëse rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit është njohur me materialet e administruara gjatë hetimit administrativ, ishte detyrë e tij të provonte të kundërtën e këtyre rezultateve dhe të sillte dokumentacion provues sipas pretendimeve të tij. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk sollti dokumentacion provues lidhur me mospasjen dijeni për vlerësimet e Prokurorisë së Përgjithshme, ndaj pretendimet e tij lidhur me këtë shkak ankimi,

mbetën të paprovuara dhe në nivel deklarativ. Sa më sipër, shkak i ngritur nga subjekti i rivlerësimit, nuk gjendet i bazuar.

19. Nga sa rezultoi më sipër, lidhur me kriterin e aftësive profesionale, Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit shfaq modele të njëjta pune, të përsëritura, me problematika të ngjashme thuajse në të gjitha dokumentet objekt vlerësimi, duke u gjendur në situatat ku nuk identifikohet drejt norma penale, vendimmarrjet janë të paarsyetuara dhe të paargumentuara, si dhe nuk identifikohen elementet e veprës penale, si analiza bazë për të arritur në konkluzionin e ekzistencës ose jo të veprës penale. Në të gjitha dokumentet objekt shqyrtimi, referuar edhe raportit të KLP-së, subjekti i rivlerësimit nuk analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, si dhe mënyra e përshkrimit të faktit penal nuk është në standardin e gjuhës ligjore. Në rastet që është disponuar me vendim pushimi, rezultojnë të jenë të paargumentuara dhe pa kryer veprime të tjera hetimore shtesë për të përligjur këto vendimmarrje. Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, datë 18 janar 2017, në paragrafin 54 të tij citohet: *Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias).*

19.1 Në përfundim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, Kolegji vlerëson se rastet kur shkeljet e subjekteve të rivlerësimit evidentohen që përsëriten në mënyrë të vazhdueshme dhe në praktika të ndryshme, përbëjnë përjashtim nga rastet e konfirmimit në detyrë dhe duhet të vlerësohen negativisht. Si rrjedhojë, kjo gjendje e përsëritur e gabimeve në gjykim, dëshmon për praninë e mangësive profesionale²³, të evidentuara në procedimet penale të vlerësuara në këtë çështje dhe, që siç parashikohet në nenin 44, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit vlerësohet “i papërshtatshëm” nga vlerësimi i aftësive profesionale, pasi në përputhje me interpretimin pajtues të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, konstatohen raste të gjykimeve me gabime thelbësore, serioze dhe të përsëritura. Nisur nga sa më sipër, konsiderohet se nga faktet e çështjeve të konstatuara, subjekti i rivlerësimit rezulton me mangësi të njëjta, të përsëritura për të paktën: (i) aftësitë profesionale; (ii) aftësitë organizative; (iii) arsyetimin ligjor; dhe, si rrjedhojë, Kolegji arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Spartak Çoçoli nuk mund të gëzojë besimin e publikut për të qëndruar në detyrë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për

²³ “I papërshtatshëm”, kur subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, nuk është efektiv në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund ta zgjidhë këtë çështje për një vit, ose nuk ka kaluar me sukses testimin pranë Shkollës së Magjistraturës.

plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit, shkaqe këto të cilat çojnë në zbatimin e nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

20. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, mbështetur në tërësinë e konkluzioneve të mësipërme dhe në legjislacionin e zbatueshëm, pasi analizoi të gjitha shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore të përbërë nga aktet e përcjella në Kolegj nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit arriti në konkluzionet e mëposhtme.

20.1 *Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*, trupi gjykues vlerëson se në disa nga çështjet penale të shqyrtuara në këtë gjykim, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore, ndërsa në çështje të tjera, nuk ka administruar prova të besueshme, të cilat do të çonin në nxjerrjen e një përfundimi të saktë në lidhje me ekzistencën e elementeve të veprës penale. Vendimmarrjet objekt shqyrtimi rezultojnë me arsyetim të dobët dhe të pambështetura në prova e në analizë objektive. Po ashtu, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar të drejtat e palëve për njoftimin e vendimmarrjeve. Në rastet kur gabimet e subjekteve të rivlerësimit evidentohen që përsëriten në mënyrë të vazhdueshme dhe në praktika të ndryshme, përbëjnë përjashtim nga rastet e konfirmimit në detyrë dhe ato duhet të vlerësohen negativisht. Mangësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, në funksionin e prokurorit, bien ndesh me kërkesat e parashikuara në nenin 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në kuptim të nenit 44, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016 dhe, si rrjedhojë, trupi gjykues arriti në konkluzionin për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vijueshmërinë e funksionit të tij.

20.2 *Për vlerësimin tërësor të çështjes*, konkluzionet e arritura gjatë kontrollit të kriterit së figurës për subjektin e rivlerësimit, të ndërthurura²⁴ me vlerësimin e çështjeve gjatë vlerësimit profesional, konsiderohen se e vendosin subjektin e rivlerësimit Spartak Çoçoli në situata të përsëritura në shkelje të ligjit, të cilat kanë elemente të qëndrimeve të njëanshme në vendimmarrje dhe rëndojnë pozitën e tij si prokuror. Këto veprime, të vlerësuara në tërësinë e tyre, cenojnë rëndë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

20.3 Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Spartak Çoçoli gjendet në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 61, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 274, datë 16.07.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

²⁴ *Procedimi penal nr. {***}, cituar në paragrafin 14.5 të këtij vendimi dhe procedimi penal nr. {***}, cituar në paragrafin 15.11 të këtij vendimi.*

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 274, datë 16.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Spartak Çoçoli.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 06.07.2022.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi